

HUMBJE E IDENTITETIT OSE...?



Humbje e identitetit ose dalje dhe prosperitet? - projekt për dekonstruimin e narativave nacionaliste dhe lajmeve të rrejshme, në frymën e zgjidhjes së çështjes së Maqedonisë me emrin

CIVIL

HEINRICH BÖLL STIFTUNG
BOSNA I HERCEGOVINA | MAKEDONIJA | ALBANIJA

HUMBJE E IDENTITETIT OSE...?



Humbje e identitetit ose dalje dhe prosperitet? - projekt për dekonstruimin e narativave nacionaliste dhe lajmeve të rrejshme, në frymën e zgjidhjes së çështjes së Maqedonisë me emrin

HUMBJE E IDENTITETIT OSE...?

Autore dhe autorë (sipas radhitjes së teksteve të publikuara):

Xhabir Deralla, d-r Sasho Ordanoski, d-r Mirjana Najçevska, d-r Mirjana Maleska, d-r Katerina Kollozova, Ljubço Georgievski, Diana Tahiri, Mersija Smailloviq, Vojo Manevski, Xvezdan Georgievski, Sinisha Stankoviq

Botues: CIVIL - Qendra për Liri

Për botuesin: Xhabir Deralla

Redaktor i publikimit: Sinisha Stankoviq

Drejtor i projektit: Xhabir Deralla

Redaksia: Biljana Jordanovska, Maja Ivanovska, Diana Tahiri, Angella

Petrovska, Natasha Cvetkovska, Dehran Muratov, Xhabir Deralla, (rregullim, dizajn dhe ilustrime)

DTP: Arian Mehmeti

Shtyp: NT Shtypshkronja "Dule 99", Shkup

Tirazh: 100 kopje

Ky publikim është pjesë e projektit "Humbje e identitetit ose shpëtim dhe prosperitet?" i CIVIL - Qendrës për Liri, në partneritet me Fondacionin Hajrih Bell.

Gjetjet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të autoreve dhe autorëve dhe nuk i reflektojnë me domosdoshmëri ato të implementuesve të projektit.

Kontakte:

Civil, Maksim Gorki 31/1, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

+389 2 520 91 76 | civil@civil.org.mk

Platforma mediatike e CIVILit:

www.greencivil.mk

www.civilmedia.mk, www.drejt.mk, www.civil.today, www.civil.org.mk, www.rtvcivil.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

ISBN-10 608-4815-20-0

ISBN-13 978-608-4815-20-4

EAN 9786084815204

- 05 Xhabir Deralla**
Për identitetet, nga të gjitha aspektet, pa ndalesa (hyrje)
- 11 d-r Sasho Ordanoski**
Gjeneratat e reja i tejkalojnë identitetet etnike, kom bëtare dhe fetare!
- 19 d-r Mirjana Najçevska**
Identiteti etnik i "fshiu" të gjitha identitetet tjera!
- 25 d-r Mirjana Maleska**
Rruga drejt normalizimit të marrëdhënieve me Gre qinë është e hapur!
- 35 d-r Katerina Kollozova**
Marrëveshja me Greqinë e mundëson përcaktimin politik të identitetit
- 39 Ljubço Georgievski**
Identiteti "Antik" na grindit me fqinjët dhe me bash kësinë ndërkombëtare!
- 47 Diana Tahiri**
Identitetet e mia nuk janë vetëm përqindje e nevojshme
- 51 Mersiha Smailloviq**
Të ndërtojmë shoqëri në të cilën të gjithë do të jemi qytetarë të Evropës !
- 57 Vojo Manevski**
Identitet "A la Shtip"
- 65 Xvezdan Georgievski**
Kultura dhe tradita janë më të rëndësishme për përkatësinë e dikujt, sesa vetë emri!
- 71 Sinisha Stankoviq**
Dua të jetoj në shtet me të gjitha nishanet në të cilin nuk do t'i numërojmë rruazat e gjakut



Për identitetet, nga të gjitha aspektet, pa ndalesa

Është e domosdoshme të kuptohen ngjarjet dhe proceset, që të formohet mendim dhe të planifikohet veprimi, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel kolektiv, si në sferën e shoqërisë, ashtu edhe në domenet që nënkuptohen nën termet institucion dhe shtet. Ky projekt është përgjigje e kësaj nevojë. Duke filluar me analiza bravuroze të trendëve globale dhe të proceseve të rëndësishme historike dhe shoqërore politike të cilat janë domosdoshëm të lidhura mes vete, ky projekt paraqet resurs publik unik, me përgjigje të çështjeve thelbësore për realitetin e Maqedonisë, rajonal dhe botëror në të cilin jetojmë.



KONTEKSTI

Procesi i shpejtuar për tejkalimin e kontestit për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë, i cili zgjat pothuajse tre dekada, ka shkaktuar rrëmujë të retorikës nacionaliste dhe tensione në dy vendet. Pensionet filluan me Samitin në Davos, në janar të vitit 2018, kur liderët e dy shteteve, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, e filluan procesin e shumëpritur për zgjidhjen e kontestit i cili më vonë rezultoi edhe me Marrëveshjen e Prespës për tejkalimin e kontestit për emrin.

Nacionalistët, të mbledhur rreth partisë së mëparshme qeverisëse të VMRO-DPMNE dhe partisë më të vogla, të cilat në mënyrë të hapur mbështeten nga Rusia, filluan fushatë me gjuhë të urrejtjes deri tani të paparë, dhe retorikë radikale nacionaliste, e shoqëruar me adresime inflamatore publike nëpër gjithë vendin. Qysh në fillimin e procesit, e veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës më 17 korrik të vitit 2018, radikalët organizuan disa protesta të dhunshme, me qëllim t'u kundërshtohen orvatjeve të Qeverisë për tejkalimin e kontestit.

Marrëveshja e arritur ishte e përshëndetur nga e gjithë bota dhe nga shumica e qytetareve dhe qytetarëve në Maqedoni, të vetëdijshëm se ndryshimi i emrit të vendit është i domosdoshëm, të njohur ndërkombëtarisht si IRJM, në Republika Maqedonisë së Veriut, me qëllim të shpejtohen integrimet euro-atlantike të cilat ishin plotësisht të bllokuara gjatë sundimit 11 vjetor të një regjimi autokrat, nacionalist dhe kriminel. Opozita nacionaliste e quajti Marrëveshjen e Prespës “kapitulluese”, duke pretenduar se ajo do ta rrezikojnë trashëgiminë kulturore, etnike, nacionale, historike dhe gjuhësore të Maqedonasve etnikë. Fushatën e tyre e zbatonin me retorikë ultra nacionaliste dhe retorikë ekskluzive, ndërsa shfrytëzonin me gjuhë eksplicite dhe gjuhë të urrejtjes kundër të gjitha komuniteteve etnike që jetojnë në Maqedoni,



e në veçanti kundër Shqiptarëve dhe Romëve, ndërsa krijonin edhe atmosferë të linçimit publik kundër Maqedonasve të cilët e mbështetën Marrëveshjen historike mes dy vendeve. Narativi nationalist ishte i shoqëruar edhe me produksion të menduar mirë dhe të sponsoruar shtrenjtë të lajmeve të rrejshme që ishin të shpërndara përmes rrjeteve sociale dhe në një pjesë të medive elektronike në vend.

Kjo gjendje në vend u ashpërsua disa herë më tepër në periudhën e zbatimit të referendumit që u mbajt më 30 shtator të vitit 2018. Si pasojë e fushatës së zezë që kishte për qëllim ta frikësojë dhe ta pasivizojë shumicën pro -perëndimore dhe të moderuar të qytetarëve në vend, referendumi kishte sukses të pjesërishëm (37% dalje, nga të cilat 91% u deklaruan pozitivisht). Suksesi i pjesërishëm i referendumit a të bëjë me lëshimet e institucioneve të shtetit.

Tensionet dhe retorika nacionaliste vazhduan pas mbarimit të referendumit, ndërsa vendi ende po përballet me tensione dhe jostabilitet.

Për të gjitha këto arsye, shoqëria e Maqedonisë mbetet thellë e ndarë në vija etnike, fetare dhe politike, në të cilat sentimente kundër perëndimit shpërndahet përmes gjuhës së urrejtjes dhe lajmeve të rrejshme, e shpesh edhe me dhunë të drejtpërdrejtë.

BAZIMI

Menjëherë pas zbatimit të referendumit në të cilin qytetarët dhe qytetarët me të drejtë vote kishin mundësinë të deklarohen për ose kundër Marrëveshjes së Ohrit për tejkalimin e kontestit me emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë, Civili dhe Fondacioni Hajnrih Bell nga Gjermania e njohën nevojën për një shikim gjithëpërfshirës të proceseve lidhur me çështjet e identitetit.

Situatat shoqërore dhe politike në Maqedoni për një kohë të gjatë nuk janë qetësuese. Regjimi i Gruevskit ka lënë gjurmë



të thella në indin shoqëror dhe e deformon mënyrën e veprimit politik dhe të pranimit të vlerave themelore civilizuese, i shkatërron kulturën, arsimin dhe shkencën. Politika shkatërruese e regjimit ka zbatuar një inxhinieri agresive sociale në bazën e të cilës ishin të vendosura mitet e fabrikuara për prejardhjen dhe identitetin e Maqedonasve etnikë. Pastaj, këtu ishin edhe “komplotet e errëta” të Perëndimit të “qelbur”, e posaçërisht të shteteve fqinje, para së gjithash, Greqia, Shqipëria dhe Bullgaria, të cilat në mënyra të ndryshme janë të kyçura në “vjedhjen” e çdo gjëje maqedonase dhe rrezikun nga “njollosja” e “gjakut dhe truallit të lashtë dhe të shenjtë”, me pakicat skajshmërisht “ të pafalënderueshme dhe grabitqare” në vend.

Formulë e përsosur për sundim të gjatë: të shpien, nëse nuk ekzistojnë, armiq të brendshëm dhe të jashtëm dhe të mbahet shoqëria nën stres të vazhdueshëm dhe frikë për mbijetesën, ndërsa regjimi të paraqitet si mbrojtës i dërguar nga qielli.

Gjeneratat e ardhshme të liderëve politikë do të duhet patjetër të bëjnë përpjekje të mëdha për tejkalimin e pasojave dhe gjendjeve të cilat shpesh nuk janë të dukshme, ndërsa janë pjesë e gjallërimit shoqëror, kulturor dhe politik. Kjo nënkupton luftë të gjatë dhe të vendosur kundër nacionalizmit në rritje dhe ndasitë etnike, fetare dhe politike. Shoqëria e Maqedonisë duhet të njohë se sentimentet në rritje kundër perëndimit dhe sentimentet pro Ruse dhe veprimi politik do ta dëmtojnë rëndë konceptin e multikulturalizmit për të cilin në këtë periudhë establishmenti politik tregon vullnet ta ubatojë në praktikë.

Ndarjet e mëtutjeshme në shoqëri do ta lëkundin stabilitetin e vendit dhe paraqesin kërcënim serioz për sigurinë nacionale dhe rajonale. Këto janë sfera të veprimit shoqëror dhe politik të cilat jo vetëm se nuk guxojnë të mbeten në skajet, por edhe të jenë pjesë e prioriteteve kur bëhet fjalë për formimin e konceptit për shoqërinë në të cilën jetojmë. Bëhet fjalë për nevojën thelbësore



nga dalja dhe shikimi përpara, drejt ardhmërisë, aspiratë drejt progresit i cili asnjëherë nuk është i kufizuar vetëm në nevojat materiale dhe mirëqenien ekonomike, dhe patjetër se është para-kusht edhe për një përparim të tillë.

KONCEPTI

Është e domosdoshme të kuptohen ngjarjet dhe proceset, që të formohet mendim dhe të planifikohet veprimi, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel kolektiv, si në sferën e shoqërisë, ashtu edhe në domenet që nënkuptohen nën termet institucion dhe shtet. Ky projekt është përgjigje e kësaj nevoje. Duke filluar me analiza bravuroze të trendëve globale dhe të proceseve të rëndësishme historike dhe shoqërore politike të cilat janë domosdoshëm të lidhura mes vete, ky projekt paraqet resurs publik unik, me përgjigje të çështjeve thelbësore për realitetin e Maqedonisë, rajonal dhe botëror në të cilin jetojmë.

PRANDAJ...

Duke u nisur nga nevoja e thellë për artikulin, mendimin dhe riartikulin e përcaktimeve, perceptimeve dhe praktikës të lidhur me çështjet e identitetit që cilat janë në thelbin e kontestit mes Maqedonisë dhe Greqisë, por edhe më gjerë, Civili vendosi konceptin për një projekt gjithëpërfshirës dhe të shtresuar i cili njëkohësisht paraqet platformë të hapur për veprim të mëtutjeshëm.

Qëllimi kryesor i projektit është t'i kundërshtojë gjuhës së urrejtjes dhe lajmeve të rrejshme me të cilat është i sulmuar procesi i nisur me Marrëveshjen e Prespës dhe ta forcojnë vetëdijen për dimensionet e vërteta dhe përfitimet për tërë vendin. Edhe më tepër nga kjo. Ky projekt është thirrje e llojit për tejkalimin e kulturës së sjelljes armiqësore dhe destruktive në diskursin publik, dhe të promovohet kultura e dialogut dhe promovim i vlerave



dhe ideve bashkëkohore, progresive.

Prandaj, ky projekt ka ftuar intelektualë të shquar dhe krijues të opinionit publik të flasin dhe të shkruajnë për kuptimet dhe përvojat e tyre të cilat projekti do t'i ballafaqojë me lajmet e rrëshme dhe dimensionet destruktive të retorikës nacionaliste, dhe veprimet kundër perëndimor. Këto janë emra të njohur nga fusha e shkencës, politikës, mediave dhe shoqërisë qytetare, t'i ndajnë me opinionin gjetjet dhe qëndrimet e tyre në aspektin e çështjeve të identitetit nga aspekte interesante.

Во проектот учествуваше целиот тим на ЦИВИЛ од кои некои се појавија и како авторки и автори на панел дискусијата и во книгата што произлегува од неа, а другите се авторки и автори во медиумската продукција на организацијата и креаторки и креатори на активностите за јакнење на јавната свест.

Në projektin mori pjesë i gjithë ekipi i Civilit, nga i cili disa u paraqitën edhe si autore dhe autorë në panelin dhe në librin që del nga ai, ndërsa tjerët janë autore dhe autorë në prodhimin mediatik të organizatës dhe krijuese dhe krijues të aktiviteteve për forcimin e vetëdijes publike.



Gjeneratat e reja i tejkalojnë identitetet etnike, kombëtare dhe fetare!

Gjenerata e sotme, posaçërisht gjenerata më e re, jetojnë së paku dy lloje të identiteteve. Njëri është identiteti real, dhe ai është mjaft i fragmentuar, ai me të cilin ecin në jetën e përditshme në të cilin janë të zgjuar në mënyrë sociale, në të cilin janë në kontakt të drejtpërdrejtë social. Por, njëkohësisht jetojnë edhe në identitet virtual. Ky identitet virtual për ata bëhet edhe më i rëndësishëm, atë që e kultivojnë për vete, dhe fillojnë edhe më tepër të besojnë në atë, sesa në identitetet reale, për atë se si duken në Fejsbuk, Instagram, çfarë cicërojnë, cilat janë faqet e tyre në Fejsbuk, në kuptim – çfarë postojnë për veten, që tjerët t'i konsiderojnë si të tillë, siç duan të jenë...



BNë kohën e sotme është rëndë të bisedohet në mënyrë të vjetër për atë se çfarë rëndësie do të kenë dhe si do të formohen identitetet kolektive dhe personale. Definicionet e mëparshme që nënkuptonin një situatë shumë më statike nga formimi i atyre identiteteve, sot i kundërshtojnë mënyrës së re në të cilën formohen dhe zhvillohen këto kategori më dinamike, ndikimi i tyre është pa dyshim më i madh, por edhe pavarësisht nga disa stereotipe nacionale, pavarësisht nga disa korniza nacionale në të cilat bëhen orvatje për zhvillimin e disa identiteteve.

Definicionet se sovraniteti i shteteve, të etabluara dhe vetëm sisteme të vetme shtetërore, siç janë ato për arsim, për kulturë, mund të ndikojnë mbi komunitetin edhe mbi formimin e identiteteve të përbashkëta, e me këtë edhe identitetet individuale, sot veç janë koncepte të vjetruara. Njeriu bashkëkohor i sotëm është i ballafaquar me milionë fragmentime të çështjeve më të vogla dhe më të mëdha që janë të lidhura jo vetëm me jetën në territor të caktuar, dhe në komunitet të caktuar, por edhe në kontakt të vazhdueshëm me një komunitet praktikisht të paku-fishëm me të cilën ai komunikon në bazë ditore, nga ku merr informata dhe të cilat nuk mbarojnë vetëm në atë që definohet si gjuha e tij, si feja e tij zyrtare, si ndonjë histori zyrtare nga e cila rrjedh, ose të gamës së traditave nga të cilat buron sistemi i tij cilësor, parabindjet, pretendimet themelore në ndërtimin e karaktereve...

Gjenerata e sotme, posaçërisht gjenerata më e re, jetojnë së paku dy lloje të identiteteve. Njëri është identiteti real, dhe ai është mjaft i fragmentuar, ai me të cilin ecin në jetën e përditshme në të cilin janë të zgjuar në mënyrë sociale, në të cilin janë në kontakt të drejtpërdrejtë social. Por, njëkohësisht jetojnë edhe në identitet virtual. Ky identitet virtual për ata bëhet edhe



më i rëndësishëm, atë që e kultivojnë për vete, dhe fillojnë edhe më tepër të besojnë në atë, sesa në identitetet reale, për atë se si duken në Fejsbuk, Instagram, çfarë cicërojnë, cilat janë faqet e tyre në Fejsbuk, në kuptim – çfarë postojnë për veten, që tjerët t'i konsiderojnë si të tillë, siç duan të jenë...

Tema për identitetet moderne, për arritjen, për humbjen e tyre..., ditë e më tepër i tejkalon bisedat për atë se çfarë është ajo që një shtet si sistem i organizuar mundet ta ofrojë, në kuptimin e një arsimi formal, e më tepër nga cilësia, diversiteti, komunikimi i atij arsimi, që t'i bëjë njerëzit pjesë e botës, dhe jo vetëm pjesë e komunitetit nacional të cilës i takojnë. Njëkohësisht, ndikimet që janë joformale dhe të cilat nuk mundet të kontrollohen nga kontrole zyrtare sistimore, janë aq të mëdha dhe janë praktikisht jashtë kontrollit të ndonjë sistemi zyrtar. Dhe ndikojnë mbi mundësinë në këtë kulturë të globalizuar, në mundësinë e paku-fizuar të komunikimit me botën. Nuk mund t'i kontrolloni valët e ndërtimit e identitetit të dikujt.

Kufijtë e privatësisë janë të lëvizura, ndera privatësia është fushë në të cilën njeriu është i preokupuar me identitetin e vet, me identitetin e fëmijëve të tij, familjes... Në këtë ndërhyrje në privatësi, nuk hyjnë vetëm shtetet me tentime për marrje të sa më tepër hapësire, ta shtyjnë hapësirën që duhet të konsiderohet si privatësi, por hyn edhe vetë gatishmëria e njerëzve, e individëve, të ofrojnë sa më tepër informata për vete, ndonjëherë pa vetëdije për kufijtë për atë se çfarë duhet të paraqet vetëm privatësia e tyre...

Kështu, ka shpërndarje të përmbajtjeve të cilat çdo herë janë konsideruar si diçka që është jeta private e dikujt. Sot, në njëfarë skene publike është e hedhur diçka që pastaj pranon jetë, dhe



që pastaj, kthehet mbi karakteristikat individuale të identitetit të dikujt, në mënyrë në të cilën ai nuk mund të kontrollohet

Me fjalë tjera, të bisedohet për humbjen dhe fitimin e identiteteve në këtë kohë moderne, e në fakt të bisedohet për arsim sa më të mirë të njerëzve, përfshirje sa më të mirë në atë që nënkuptohet si botë e globalizuar, të bisedohet për vetëdijesimin për atë se ku janë kufijtë e privatësisë dhe çfarë nuk mund të përdoret dhe të keqpërdoret në atë sferë. Të jesh i vetëdijshëm se më nuk ekzistojnë kufizime fizike, gjeografike, kultura të vogla siç është kultura maqedonase dhe kulturat tjera që ekzistojnë këtu, siç është modeli kulturor shqiptar, këto janë kultura të ekspozuara në ndikime aq të mëdha sa që nuk mund të mbrohen në mënyrë tradicionale komponentët e tyre të identitetit. Sot, praktikisht, nëse dikush nuk e flet gjuhën angleze, kot e ka nëse e ka të përsosur gjuhën maqedonase, sepse plasmani i kësaj gjuhe në kohën moderne ditë më tepër varet edhe nga mundësia të komunikohet me botën që nuk mbaron në Tabanovcë, por zgjerohet në tërë globin.

Identitetet e sotme janë identitete konfuzioni, identitete të cilat shpesh janë një proces i menaxhimit me krizat, në një sfidë të përditshme të përballeni me kontestimet të cilat nuk bëhen në ndonjë bazë kontrolluese të domosdoshme nacionale etnike, por të bëhen në kuptim të asaj – a jeni të aftë ose jo, të hyni në struktura më të larta terciare në jetën individëve dhe komuniteteve, e kjo do të thotë, të jesh i përgatitur mjaftueshëm me të gjitha cilësitë për komunikim me tërë botën... Në këtë kuptim, shteti e ka rolin e vet, sepse, megjithatë, ky është një sistem i organizuar në shoqëri, i cili kontrollon rrjedha të caktuara që janë të rëndësishme për formimin e identiteteve. Para së gjithash, mendoj në



strukturat formale të arsimit, përmbajtjet që mësohen, pastaj trajtimi i familjes dhe kushte më të mira të statusit, sociale në të cilat zhvillohen familjet, por, gjithashtu, edhe komuniteti shoqëror i cili në të gjitha dimensionet e veta, jo vetëm politike, ndikon mbi zhvillimin dhe ndryshimin e cilit do identitet. Pra, shteti i ka ato mundësi sepse disponon me resurse të cilat mund të ndikojnë, mirëpo, pas një kufiri të caktuar druaj se edhe ndërhyrjet formale të sistemeve shtetërore nuk janë më në gjendje, as kanë mundësi, ta përcaktojnë dinamikën e zhvillimeve të identiteteve...

Është fakt se gjeneratat e reja veç më gjenden në situatë kur kanë nevojë të theksuar për tejkalimin e identiteteve të tyre etnike, kombëtare, fetare. Goditje e kthyer e caktuar është që, megjithatë, edhe në këtë transparencë të madhe të kulturës globale, njerëzit hyjnë me bindje, me stereotipe dhe me kërkim pas vërtetimit të asaj që veç më e kanë si stereotip në vete, edhe përkaj ofertës informative që është aq e madhe sa që praktikisht është e pakufizuar. Megjithatë, hyjnë në kërkime më të ngushta të asaj që do ta vërtetojë karakterin e tyre, identitetin e tyre, vlerat e tyre, bindjet që i mbajnë në vete. Prandaj, shpesh zgjedhin, në një kombinim të presionit ditor, me mundësi të pakufizuara, të zgjedhon të bëhen statikë, të bëhen konservativë në zgjedhjet e tyre, madje edhe të radikalizohen, veçanërisht në kuptim politik...Kjo, kuptohet, kthehet me rritjen e nivelit të pasigurisë, të frikës edhe të individëve edhe të komuniteteve, që çon drejt një kontraksioni në kuptim politik, i cili i bën aq më konservativ në nivelet e tolerancës ndaj tjerëve, në nivelet e pranimit të përvojave të huaja...

Kjo garë e cila për momentin po zhvillohet mes presionit të një skene kulturore të globalizuar, skene të globalizuar politike – shoqërore dhe nevojës për një siguri të identitetit personal, sjell



deri te një dozë e fërkimit në individët te vetë personat. Këto doza të fërkimit reflektojnë me një varg, jo vetëm të patologjive shoqërore, por edhe llojeve tjera të patologjive psikike, personale... Depresionet janë në rritje, ka rritje të madhe edhe të fobive të ndryshme, të cilat janë rezultat i rrethanave të caktuara në të cilat jetojmë, gj që kontribuon për një kontraksion shoqëror në të cilin, në vend se të ofrohet dhe të shfrytëzohet më e mira që e mbajmë, shpesh anojmë nga ajo që paraqet një mënyrë jo produktive e perceptimit të realiteti të perspektivave personale, të perspektivave të komunitetit...

Pra, në fund dëshiroj të them se, ndërtimi, ruajtja, ndryshimi i moderniteteve është diçka që u kundërshton mënyrave tradicionale, asaj se si kohë më parë janë definuar karakteristikat e identitetit dhe proceset e formimit, se ditë e më tepër ky lloj i dinamikave konflikte të identitetit..., varen nga faktorë që janë jashtë kontrollit të strukturave formale të shoqërisë dhe të shteteve.

Jemi të drejtuar para një batice të madhe të ndikimeve për të cilat, që të mundemi ti përpunojmë në mënyrë konstruktive, është e domosdoshme të kemi persona që do të munden – për shkak të arsimimit të tyre, për shkak të statuseve sociale dhe roleve të tyre në shoqëri, në vitet adoleshente dhe post – adoleshente, të jenë të qëndrueshëm dhe rezistues ndaj shtrembërimit dhe ecjes në drejtim shkatërrues, malinj shoqëror. Kjo është sfidë e vështirë për çdo shoqëri moderne, e shohim se edhe individët, personat në komunitete shumë më të mëdha kulturore, shtetërore nga Maqedonia, kalojnë sfida të mëdha. Mirëpo, mendoj se në fund, nuk ekziston zgjidhje tjetër, përveç të krijojmë gjenerata të cilat në atë mënyrë do të kenë rezistencë dhe ti kundërshtojnë sfidat e këqija



para të cilave do të jenë të drejtuar në një perspektivë të afërme dhe të dukshme.

Në këtë kuptim, të jem aktual në mënyrë politike, kur i shoh diskutimet e sotme se si ndryshimi i Kushtetutës së Maqedonisë, ose se si pasojat nga Marrëveshja e Prespës eventualisht do të ndikojnë mbi çështjet e identitetit të Maqedonasve, duhet të them se te unë mbizotëron një ironi. Identitetet moderne të kulturave oficiale, komuniteteve shtetërore-shoqërore, ndikojnë mbi atë se si në fakt, zhvillohen identitetet në realitet. Sipas asaj se çfarë do të shkruan në kushtetutë dhe a do të jetë e mbrojtur gjuha maqedonase me supozime kushtetuese se si do të jetë, a do të kenë targat e automjeteve shënime të atilla ose të këtilla, dhe a do ta kodojnë ekzistimin tuaj ca kode, realisht, realiteti i tillë dinamik siç e përshkruaj, kuptohet, se ka më pak rëndësi rreth asaj – nëse do të arrijmë të krijojmë sistem cilësor të arsimit! A do të arrijmë të bëjmë që procesi kulturor të bëhet proces, dhe jo vetëm prodhim, i cili do të trajtohet vetëm në mënyrë festivali, a do të arrijmë krijojmë gjenerata mjaftueshëm kreative dhe të afta dhe të arsimuara mirë të cilat do të mund ta kalojnë kufirin maqedonas dhe të mund të plasohen në botë, që të na kthehen si të tillë këtu, me përvojat e reja që do të fitojnë. Kjo do të thotë, pas tre-katër ditë nga sjellja e ndryshimeve të kushtetutës, do të jetë përmbajtje e harruar, ajo që do të vlen është nëse do të realizohen reformat në shoqëri, me të cilat do të krijojmë qytetarë të cilët do të munden të përgjigjen në ofertën moderne dhe kërkesat nga bota, sepse ne jemi pjesë e botës. Ne nuk jetojmë në kufijtë tona, nacionale klaustrofobike, në të cilat grindemi për tema triviale nga historia, për personazhet nga ajo, të kthyer prapa, në vend se përpara...



d-r Sasho Ordanoski: Gjeneratat e reja i tejkalojnë identitetet etnike, kombëtare dhe fetare!

Me fjalë tjera, në këtë materie duhet pasur qasje të guximshme, sepse perspektiva nuk nënkupton të dëshironi diçka dhe të frenoni dhe ta trajtoni në mënyrë statike, por duhet të jeni të përgatitur për atë që nënkupton një situatë dinamike internacionale në të cilën i zhvilloni në konkurrencë me të gjithë tjerët, identitetet tuaja, dhe të huajat.

d-r Mirjana NAJÇEVSKA



Identiteti etnik i “fshiu” të gjitha identitetet tjera!

Marrëveshja e Prespës jo vetëm se nuk ndikon në mënyrë negative mbi identitetin e maqedonasve në Republikën e Maqedonisë dhe jo vetëm se do të mundej të shfrytëzohet për humbjen e këtij identiteti, por, përkundrazi, kështu si është i artikuluar, me dispozitat në përmbajtjen dhe atë që e ofron si një kornizë juridike për marrëdhëniet e ardhshme mes republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, ndoshta mund ta njohim si marrëveshje që i hap dyert për një pamje të re të identiteteve



Identiteti në Maqedoni në vitet e kaluara shpesh lidhet me atë që quhet identitet etnik, diçka më pak – identitet fetar, me identitetin e përkatësisë ndaj shtetit, mirëpo më pak nga të gjitha, kur flitet për identitetin, flitet për identitetin qytetar, për identitetin individual...Ky identitet nuk është kategori homogjene. Përkundrazi, ky është identitet i përbërë nga më tepër lloje identitetesh që e përbëjnë atë që paraqet identitetin e një individi të caktuar.

Jo vetëm që ekzistojnë më tepër identitete, por duhet ti kuptojmë edhe në ndryshueshmërinë e tyre, në fleksibilitetin e tyre. Në moment të caktuar një njeri mund t ketë një identitet, në moment tjetër mund të ketë identitet tjetër, në një moment mundet një identitet të jetë dominues, në tjetër moment tjetri...Për shembull, për një çështje të caktuar, unë si njeri mund të identifikohem me profesionin tim, mund të identifikohem si juriste...Për çështje tjetër, mund të identifikohem me ndonjë interesim, për shembull, mbrojtjen e mjedisit jetësor ose me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që paraqet përcaktim të identitetit. Në një moment të tretë, mund të identifikohem me diçka krejtësisht tjetër. Me atë që paraqet identitetin e nënës, bashkëshortes, etj...

Homogjenizimi që u bë viteve të kaluara dhe vendosja e identitetit vetëm në korrelacion me etnicitetin, i fshiu të gjitha mundësitë tjera. Dhe në fakt, i vendosi njerëzit në kallëp – të duhet patjetër ta njohin veten vetëm përmes këtij, identiteti kombëtar ose etnik. Në fakt, i varfëroi, u pamundësoi të identifikohen me identitete tjera, u pamundësoi të shkojnë nga njëri në tjetër identitet, i pamundësoi të shoqërohen me njerëzit tjerë me të cilët ndajnë ndonjë nga identitetet e tyre të ndryshme...

Pse është e rëndësishme Marrëveshja e Prespës për të gjitha këto? Sepse e rrënon identifikimin e vetëm dhe homogjen të njerëzve me etniken. E dyta, për arsye se hapet ambient për ndërtimin e identiteteve të reja, diçka që në moment të caktuar ka qenë e ndërprerë madje edhe e ndaluar! E treta, hapet mundësi



për komunikim në një nivel tjetër, komunikim kulturor, arsimor, politik dhe ekonomik me njerëz me të cilët, në një mënyrë, gjatë gjithë kohës kemi pasur barrierë pikërisht për shkak të vendosjes së atij identiteti të vetëm, homogjen, etnikisht të orientuar.

Elementi i dytë ndaj të cilit duhet drejtuar vëmendjen është edhe absurditeti dhe anakronizmi i ekzistencës së etnisë, jo vetëm si identiteti i vetëm, por, madje edhe një nga identitetet. Sepse njerëzit rastësisht lindin në një komunitet të caktuar etnik... Shumë rastësisht lindin në një komunitet të caktuar kulturor. Shumë rastësisht lindin në një shtet të caktuar. Dhe ajo që i ndërton si qenia të veçanta njerëzore që kanë background të posaçëm kulturor, qenie njerëzore që kanë lidhje të caktuara me njerëzit tjerë edhe në komunitetin më të gjerë, është diçka që nuk guxon të lidh. Kjo është diçka që duhet të pasuron. Kjo është diçka që duhet të shton elementin e dallueshmërisë. Kjo është diçka nuk duhet t'i ndajë nga njerëzit tjerë, por përkundrazi, t'i lidhë me ata, sepse kanë një veçanti të cilën mund ta ndajnë, diçka të cilën mundet ta shtojnë në atë që paraqet ndërtim të identitetit të përgjithshëm si një kategori shumë heterogjene. Ajo që sipas meje na e mundëson Marrëveshja e Prespës është pikërisht hapja e derës për një perceptim më të ndryshëm të pikërisht këtij aspekti të identiteteve.

Mirëpo, ka edhe një moment që është shumë i rëndësishëm dhe të cilin ndoshta d të mundemi ta realizojmë me ngjalljen e kësaj marrëveshje, e ajo është lufta më ndërtimin e identiteteve të rrejshme. Mungesa e asaj që paraqet identitet qytetar dhe identitet individual, mungesa e asaj që paraqet ndërtim të sotëm dhe të ardhmërisë, shpesh zëvendësohet me ndërtimin e lidhjeve të rrejshme, të konstrukteve të rrejshme në histori... Në fakt, nuk mund të them as në histori, por në një të kaluar të imagjinuar... Konstrukti i tërësishëm i asaj që paraqet rrënjët, prejardhjen, që hyn në mijëra vite pas dhe është interesante nga aspekti i ndërti-



mit të kulturës së përgjithshme njerëzore, nuk mund të lidhet me ndërtimit të identitetit individual. Ky është problemi kryesor të cilin ndoshta edhe mund ta zgjidhim, nëse fillojmë ta praktikojmë dhe aplikojmë në mënyrë të përshtatshme Marrëveshjen e Ohrit.

Kjo do të na mundësojë t'i kundërshtohemi shkëlqimit të rrejshëm të së kaluarës që po ndërtohet rreth nesh. Të gjitha prapaskenat e të kaluarës të cilat gjatë 11 viteve të kaluara ishin të vendosura dhe ndërtimi i tërë asaj që paraqet iluzion në lidhje me një të kaluar shumë të largët që nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë ndikim mbi atë që paraqet pozita e sotme e njerëzve në Republikën e Maqedonisë, interesat dhe nevojat e sotme, jo vetëm të individëve, por edhe të tërë shtetit.

Elementi katërt të cilin unë do ta paramendoja në atë që paraqet aspektin pozitiv, inputin pozitiv të Marrëveshjes së Prespës – vendosja në komunitet më të gjerë. Ndërtimi jo vetëm i identitetit evropian, por edhe i atij botëror. Gjë me të cilën njerëzit do të fillojnë ta konsiderojnë veten si pjesë e një familjes më të gjerë, si pjesë e asaj bashkësie në të cilën dallimet i tejkalojnë dallimet etnike, fetare, gjuhësore, dhe fillojnë të shkrihen në atë që paraqesin dallimet kulturore, dallimet në mënyrën e jetës, në mendim, në ndërtimin e qëndrimeve dhe në mundësinë të pranohet dallueshmëria... Kjo është me siguri përfitimi më i madh i cili, sipas meje do ta kemi nga Marrëveshja e Prespës.

Kjo aspak nuk do të thotë se kjo marrëveshje është ndonjë marrëveshje ideale. Kjo aspak nuk do të thotë se kjo është marrëveshje që mund të jep përgjigje për të gjitha pyetjet e mundshme dhe veçanërisht jo se kjo është marrëveshje e cila me automatizëm do të jetë pozitivisht e implementuar. Thjeshtë, na mbetet ta marrim atë që paraqet momentin më pozitiv të Marrëveshjes, na mbetet nga vetë marrëveshja t'i marrim aspektet pozitive që do të na mundësojnë ta kuptojmë heterogjenesen dhe dallimin e identiteteve të çdo kujt nga ne si individë, që pastaj të



mundemi ta kuptojmë heterogjenen, diversitetin dhe fleksibilitetin e identiteteve që ekzistojnë në komunitetin më të ngushtë dhe më të gjerë. Kjo, në nivel të caktuar do të na mundësojë jo vetëm trajtim formal, por edhe trajtimin faktik të njerëzve si të barabartë, gjegjësisht, trajtimin e njerëzve si të barabartë në dallueshmërinë e tyre të plotë, përballë dallueshmërisë së tyre, gjegjësisht, duke e marrë parasysh diversitetin e tyre.



d-r Mirjana MALESKA



Rruga drejt normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë është e hapur!

Momenti i përputhjes së interesave të fuqive të mëdha për të siguruar paqen dhe stabilitetin në Ballkan, në të cilën ata kanë investuar shumë dhe kanë siguruar praninë e tyre në rajon, në krahasim me fuqinë e Ruisë, për fat të mirë përputheshin me interesat strategjike të vendit tonë për t'u bërë anëtare e NATO dhe BE. Siç tha miku ynë i vjetër nga 2001, ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Xhorxh Robertson : “Yjet u radhitën për Maqedoninë”.



Duke u përgatitur për këtë debat rilexova dy biseda të cilat para 10 vitesh si redaktor i “New Balkan Politics”, i publikova në temën kontesti mes Maqedonisë dhe Greqisë për emrin. Këto publikime ende janë në ueb faqet e kësaj magazine ndërkombëtare. Do të kthehem shkurtë te këto biseda që opinioni të mundet të kuptojë, se sa atë kohë kemi qenë larg kompromisit dhe çfarë hapi të madh bëjmë sot.

Biseda e parë është me presidentin e atëhershëm të Komitetit të Helsinkit të Greqisë, i cili ishte i akuzuar për tradhti nacionale, Panajote Dimitras, aktivist i njohur kundër nacionalizmit dhe ksenofobisë greke, ndërsa biseda e dytë është me një nga shkrimtarët më të shquar grekë me qëndrime liberale, Nikos Dimu.

Dimu e lutëm për intervistë pasi në blogun e tij e publikoi tekstin me titull: “Nacionalizmi e kërcënon demokracinë në Greqi”, dhe i cili, patjetër, me ndryshime shumë të vogla, mund të reflektohet edhe te nacionalizmi maqedonas.

“Nga fëmijëria ime e këndeje, historia greke i ngjante një filmi (të lirë) uestern, në të cilin grekët çdo herë janë Djemtë e Mirë. Djemtë e këqij çdo herë ndryshonin. Kishte kërcënim nga Veriu, pastaj nga Lindja, pastaj përsëri nga Veriu, dhe përsëri nga Lindja. Kur isha fëmijë, fjala Bullgar ishte mallkim më i madh se Turk. Ishte e ndaluar për Grekët e Greqisë Veriore të quhen Maqedonas, Shqiptar, atëherë kishte ton neutral, sot është kërcënim”.

Panajote Dimitras, në pyetjen çfarë është thelbi i kontestit mes dy vendeve, përgjigjet:

“Greqia refuzon të pranojë se mund të ketë edhe identitet etnik maqedonas kudo qoftë, por më me rëndësi brenda kufijve të territorit grek, ku pakicat etnike nuk janë të pranuar, qofshin maqedonas ose turqë...Grekët mund të pranojnë Maqedonia e Veriut si emër të shtetit, nëse dy palët pajtohen, por do të jetë shumë



vështirë të pranojnë se ekziston etni dhe gjuhë maqedonase, kështu që nuk mund edhe të pritet se do të mbizotërojë arsyeja”.

Këto ditë lexova se organizata e Maqedonasve nga Greqia “Ylberi”, kërkon nga Qeveria inkorporimin e gjuhës maqedonase në shkollat shtetërore dhe njohjen e pakicës maqedonase. Marrëveshja e Prespës dha edhe një nxitje për luftën e tyre për të drejtat e minoriteteve, por kjo është lufta e tyre, jo e jona...

Kontestin për emrin e kam ndjekur nga fillimit të tij zyrtar, kur Maqedonia u bë e pavarur në vitin 1991, pas shpërbërjes së përgjakshme të Federatës jugosllave, dhe kërkoi njohjen ndërkombëtare. Menjëherë u desh të përballemi me realitetin e politikës ndërkombëtare, sepse aleancat u formuan për të mbrojtur interesat e anëtarëve të tyre. Atje ku Greqia ishte anëtare, e ato ishin të gjitha organizatat e mëdha dhe të rëndësishme ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara ose Bashkësia Evropiane, dyert për ne ishin të mbyllura. Goditja më e madhe për kombin në vitet e para të pavarësisë erdhi nga Lisbona. Deklarata e qershor 1992, anëtarët e KE, të zënë me problemet e tyre dhe pa shumë të kuptuarit dhe njohuritë e gatishmërisë sonë të shprehur për të na njohin, nëse emri ynë nuk përfshin fjalën Maqedoni! I mposhti këtë goditje të tmerrshme për dinjitet kombëtar, më vonë, me ndërmjetësimin dhe mbështetjen e diplomacisë britanike, të hartohet propozim kompromisi, Republika e Maqedonisë (Shkup), i cili është në procedurë parlamentare. Jo mbërthyer në këtë proces deri në fund as ne as grekët dhe pas një farë konfuzioni në politikën e jashtme të vendit dhe divergjencja e autorëve të saj në atë kohë, Maqedonia u pranua në OKB nën referencën e përkohshme, IRJM. Unë isha në New York në atë kohë dhe në atë moment më rridhnin lot gëzimi, ndërsa nga ana tjetër kisha një gungë në fytyrë tim, për shkak të pasigurisë: si do të ndahen më tej marrëdhëniet bilaterale mes Maqedonisë dhe Greqisë, sepse nacionalistët grekë fuqishëm



protestonin jashtë ndërtesës së OKB.

Në vitin 1995, në kohën kur u nënshkrua Marrëveshja e përkohshme, isha ende në Nju Jork dhe u gëzova sepse për herë të parë përfaqësuesit e Maqedonisë dhe Greqisë i dhanë dorën njëra tjetrës. Të gjithë që u gjetëm në atë moment aty, dhe ishim pjesë e ngjarjes, u fotografuam me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB...

Nga dora e parë e di se kontesti ishte i gjatë, i komplikuar dhe thellësisht i ndjeshëm, por, në ato vite të para, ende nuk ishte në kuptim të identitetit dhe me siguri se nëse ishim këmbëngulës, kërkimi i kompromisit do të zgjidhej më herët. Mirëpo, politia e vendit iku në drejtim tjetër. Edhe pse negociatat ishin formale, asnjë politikan, me të vërtetë asnjë, pavarësisht nga cila parti, nuk e kishte ndërmend të jetë i akuzuar për tradhti kombëtare dhe shitje të interesave nacionale, sepse, ashtu sigurisht humben zgjedhjet, e ndoshta edhe koka. E gjithë atmosfera ishte e sjellur në pikë vlimi ndërsa letra me kërcënime, deri te ata që drejtonin me shtetin dhe politikën e jashtme, nuk ishin të rralla. Në fakt, atentati mbi Presidentin Gligorov në tetor të vitit 1995 është dëshmi për klimën politike në vend.

Marrëveshja e përkohshme me Greqinë e 13 shtatorit të vitit 1995 solli lehtësim, por, pasi veç më i akuzojmë Grekët se nuk i janë përmbajtur marrëveshjes, duhet të themi se edhe nga ana ynë, gjithashtu, nuk i plotësonim obligimet për kërkim të kompromisit, por, përmes rrjetit diplomatik, e rriste numrin e vendeve që na pranojnë në emrin kushtetues, me qëllim të bëhet presion mbi Greqinë. Kjo politikë nuk i zgjidhi problemet, posaçërisht anëtarësimi i vendit në NATO dhe BE, por vetëm e thelloi mosbesimin e ndërsjellë. Konfliktin me Greqinë e arriti kulmin me ardhjen e VMRO-DPMNE në pushtet, dhe u shndërrua nga problemi për emrin, në kontest të ndjeshëm të identitetit, sepse gjenerata e re e njerëzve u rrit dhe u edukua mbi mitin se jemi pasardhës të



drejtperdrejtë të Lekës së Madh.

Pse kemi hyrë në konfrontim me Greqinë duke i hedhur themelet e identitetit tonë, në, të them, territor të huaj dhe armiqësor? Shfaqje e simboleve, flamuri i Verginës, përmendoret e Aleksandrit dhe Filipit, emërtimin e rrugëve, shkollave, autostrada, objekteve sportive dhe objekteve të tjera në bazë të mbretërve të lashtë si Aleksandri, Filipi apo Aminta II, për shembull, për të cilin nuk e kishim as idenë se ka ekzistuar, as që mendonim, e gjithë kjo është bërë me qëllim për të treguar origjinën tonë të lashtë helene, dhe në këtë mënyrë pretendimin tonë për territorin e Maqedonisë së Egjeut, që për Greqinë ishte krejtësisht e papranueshme. Pas kësaj politikë të “madhe maqedonase”, u mblodhën të gjithë ata që kishin motive personale për ta mbështetur.

Për shembull, një nga këshilltarët e presidentit të shtetit dhe kolegu im më tha: “Do të bëjmë këmbim me Greqinë – ne do t’ua kthejmë antikën, kur të vjen momenti, e ata ne – emrin e shtetit”. Nuk doli ashtu. Një kolegë tjetër, gjithashtu funksionar në pushtetin e kaluar, qeshte se me antikvizimin do të tërheqim turistë dhe do të fitojmë para. Ai ishte albanofob dhe besonte në një farë bashkimi mes Greqisë dhe Maqedonisë, do të na ndihmojë të çlirohemi nga Shqiptarët, të cilët, sipas tij, janë “guri në qafë”, dhe, ne profesorët – sa bukur- do të ligjërojmë në Selanik! Sipërfaqësore dhe e rrezikshme. Një kolegë tjetër, i afërt me pushtetin, më siguronte se duhet të ikim nga e kaluara e afërt historike, në të cilën kemi gjëra të përbashkëta me Bullgarët, dhe përmes një makinerie sociale – të bashkohemi si komb rreth një miti të fuqishëm – Lekës (Aleksandrit)! Gabueshëm, sepse, të përkujtoj fjalët e Dionisios Sollomos, poetit grek të shekullit 19, kombi duhet të mësojë ta konsiderojë për kombëtare vetëm atë që është e vërtetë. Ndërsa e vërteta është se ne jemi popull i veçantë slla-



vo-jujor, i cili flet gjuhën e vet që i përket grupit të gjuhëve sllave!

Asnjë nga intelektualët dhe profesorët e përmendur nuk mendonin për çmimin që duhet të paguhet për një politikë të këtillë, të rrezikshme dhe sipërfaqësore. Ata ishin me pushtetin, arken shtetërore e kishin në dispozicion, si shpërblime fituan pozita ambasadorësh dhe privilegje tjera, pse të mendojnë?

Cilat janë pasojat e kësaj politike nacionaliste?

Ne të gjithë i njohim, lart e poshtë. U krijua konfuzion rreth identitetit, çfarë do të thotë të jesh maqedonas. Shoqëria u nda në patriotë dhe tradhtarë. Shqiptarët ishin shumë të pakënaqur me qeverinë që përdorte retorikë fyese kundër tyre dhe u mohonte sigurimin e ardhmërisë evropiane. Nga kjo pakënaqësi lindën kërkesa radikale dhe u mpreh deri në prag të konfliktit, ndarja e brendshme e forcave pro-perëndimore që, në emër të së ardhmes, janë të gatshëm për kompromis me Greqinë dhe ata që luftojnë për status-quo dhe kanë mbështetjen e Ruisë. Vendi mbeti një kohë të gjatë jashtë NATO-s, duke e sjellur në pyetje sigurinë e saj, në momente kur në Ballkan ende ka politika që konsiderojnë ndryshime të kufijve. Arritëm në gjendje ta shohim veten dhe të na shohin tjerët, si vend ardhmëri, në prag të konfliktit, vend nga i cili çdo kush mund të largohet...

Me një diplomat më të lartë grek biseduam në këtë temë. Ai ishte mysafir në shtëpinë tonë dhe në atmosferë miqësore tha se Greqia nuk ka problem me njerëz të matur dhe të mençur: "Ne duam ta nxjerrim në pah irredentizmin dhe nacionalizmin tuaj ekstrem".

Nuk duhej ta nxjerrin, vetëm duhej të presin sepse ai vet u shfaq. Bashkë me në antikomunizëm primitiv, i cili e solli në pyetje identitetin tonë bazë: se jemi komb i ri, i krijuar në një proces të lëvizjeve çlirimtare, të udhëhequr së pari nga VMRO historike, e pastaj nga Partia komuniste, e cila bashkë me forcat tjera anti-



fashiste në Luftën e Dytë Botërore, e krijoi shtetin maqedonas. Mendoj se askush nuk e kuptoi më mirë rrezikun nga antikomunizmi për identitetin nacional, nga shkrimtari dhe miku ynë, Kole Çashule. Do t'i shkruaj fjalët e tij nga “Fisi i sëmurë” (“Bolno pleme”) (2000):

“Në këtë antikomunizëm çdo gjë ishte e përzier, çdo gjë: vullnetarizmi në interpretimin e historisë, kundër euforia, injoranca dhe mbi të gjithat, uria e madhe për pushtet i cili u instrumentalizua si dëshirë për hakmarrje...U kanos rreziku i madh se bashkë me braktisjen e komunizmit do të vihet në pyetje mbijetesa e shtetit dhe se do të përtërihet mohimi i kombit. Nga këtu, edhe fakti i pamohueshëm se armiku më i madh i komplotëve kundër maqedonase, para se gjithash dhe mbi të gjitha, janë pikërisht kryengritja, LÇP, luftëtarët për afirmimin e kombit, gjuhës dhe kulturës maqedonase, dhe jo komunizmi (ashtu si është) i tyre!”

Sot, pas 27 vitesh, kthehemi te ajo që nga fillimi na e këshillonin miqtë tonë nga SHBA dhe BE, të arrijmë kompromis me Greqinë. Tani, Marrëveshja e Prespës është këtu dhe me lehtësim të madh e ndjeka hyrjen në procedurë të kuvendit. Në pyetjen nëse me këtë marrëveshje e humbim identitetin tonë, me bindjen më të madhe të njeriu me përvojë dhe profesori, them se nuk e humbim, por e forcojmë! Greqisë nuk i konvenon t'i afrohem tepër Bullgarisë dhe ministri i mëparshëm për punë të jashtme Nikos Koxijas këtë e tha hapur para opinionit grek. Cipras dhe Siriza na e ofruan dorën, sa nga bindja, aq edhe nga presioni ndërkombëtar.

“Ju jeni maqedonas, siç pretendoni, me shtetin tuaj për të cilin u kuptuam të quhet Maqedonia e Veriut, kemi historinë tonë, kulturën dhe trashëgiminë, të cilat janë të ndryshme nga civilizimi, historia dhe kultura helene në rajonin Maqedoni në Greqi nga antika deri sot, ndërsa gjuha juaj zyrtare është maqedonishtja, e cila i takon grupit të gjuhëve sllavo-jugore dhe nuk është e lidhur



me civilizimin helen, historinë dhe kulturën nga rajoni verior i Greqisë. Nën termet Maqedonia dhe maqedonas, ne dhe ju kuptojmë kontekst të ndryshëm historik – këtë e njohim dhe e pranojmë. Prej tani e tutje, do të jemi miqtë tuaj, do t'u ndihmojmë për çdo gjë dhe do t'u mbështesim..."

Me qëllim tentova ta parafrazoj vendimin e Marrëveshjes, që ka të bëjë me identitetin, në stilin e Marrëveshjes Meliane nga Tukiditi, ku ndeshen fuqia e Athinasve dhe e drejta e Melianëve, sepse një pjesë e opinionit të ne, mendon se vetëm ne jemi të padrejtesuar dhe se vetëm mbi ne ushtrohet presion të lëshojmë pe.

As nga afër nuk është kështu. Kur kontestet bilaterale, si ky, kanosen ta destabilizojnë shtetin dhe të prodhojnë konflikt i cili më vonë nuk do të mundet të kontrollohet dhe paraqet rrezik potencial për paqen dhe sigurinë rajonale, ndërhyrja e shteteve të mëdha dhe të fuqishme si SHBA dhe tjera, duhet të konsiderohet me mirëkuptim. Të mos i harrojmë mësimet nga historia se në Ruandë, për shembull, në vitin 1995, vetëm për disa ditë u vranë 500.000 njerëz dhe askush nuk u ndihmoi atyre njerëzve. Diplommatët e KB vinin dhe shkonin nga puna si çdo ditë të rëndomtë. Shembull i dytë është intervenimi i NATO në luftën qytetare në Bosnje, i cili gjithashtu ishte i vonuar, posaçërisht për 7.000 myslimanë të vrarë në Srebrenicë.

Kur fuqitë e mëdha, si pale e tretë, hyjnë si ndërmjetësues në kontest mes dy shteteve, kuptohet se u bëjnë presion të dyjave, por edhe ia shtojnë fuqinë palës më të dobët të kontestit, që ta detyrojnë më të fuqishmen, në rastin tonë- Greqinë, në kompromis. Ne, si shtet, na u dha ajo fuqi, dhe nuk është e rastit që opozita greke, e veçanërisht nacionalistët grekë, çirren se është kryer tradhti nacionale me atë që u lejua ta mbajmë emrin Maqedoni, Maqedonas, për kombin dhe gjuhën maqedonase. Deri dje, kjo as që mund të paramendohej. Momenti i përputhjes së intere-

save të fuqive të mëdha për të siguruar paqen dhe stabilitetin në Ballkan, në të cilën ata kanë investuar shumë dhe kanë siguruar praninë e tyre në rajon, në krahasim me fuqinë e Rusisë, për fat të mirë përputheshin me interesat strategjike të vendit tonë për t'u bërë anëtare e NATO dhe BE. Siç tha miku ynë i vjetër nga 2001, ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO Xhorxh Robertson: "Yjet u radhitën për Maqedoninë".

Unë nuk e idealizoj situatën që rrjedh nga Marrëveshja e Prespës. Kur të hapet një debat për ndryshimin e Kushtetutës, çdo herë paraqiten kërkesa të reja dhe shpesh jo të justifikuara dhe madje edhe shantazh nga aktorët e brendshëm politikë ose nga vendet fqinje, që mund të destabilizojë edhe më tej këtë shtet të brishtë. Megjithatë, Marrëveshja e Prespës ka sponsorë të fortë, SHBA dhe BE, kështu që shpresoj, do ta sjellim në fund procesin i ndryshimeve kushtetuese, duke u mbajtur në këtë mënyrë në këmbë. Do të ishte më e lehtë, në kohë stuhie, të jemi të bashkuar, por nga opozita nuk ka shenja se është e gatshme për bashkëpunim. Debati me grekët rreth çështjes pragmatike të Marrëveshjes, me siguri do të jetë e gjatë dhe e pakëndshme, por rruga për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, të mos e shohim njëri-tjetrin si kërcënim, është e hapur.

Do të mbaroj me adresimin tim, me disa fjalë të Nikos Dimu nga eseu i tij „The agony and the ecstasy of being Greek“, i botuar në “The Guardian”, të cilat fjalë mund të jenë edhe për ne.

“Greqia është vend i vogël me ego të madhe. Populli i saj është i ngarkuar me histori dhe mite. Çdo herë në maje të son-dazheve që e matin krenarinë kombëtare (97%)... ne e shohim veten si popull i zgjedhur... Ndashja mes egos tonë të fryrë mitike dhe realiteti i ashpër është burim i vazhdueshëm depresionit. Ne mendojmë se dihet të marrim njohje dhe trajtim të veçantë, dhe nëse nuk e marrim, ndjehemi të dëshpëruar... Fillojmë të

besojmë në teori komploti dhe ndjehemi të tradhtuar...Politika e jashtme ka qasje plotësisht emocionale (Na duan ose jo? A janë helenofilë ose helenofobë?). Ne jemi të etur për njohje, pranim dhe admirim... Ata që mendojnë se thjeshtë fryma greke qëndron në rrënjët e fitores, janë jorealë. Fryma ishte çdo herë këtu në të kaluarën – por ne vazhdimisht kemi rezultate humbëse...Asgjë nuk ndodh vetëm si rezultat i frymës. Mirëpo, nëse bashkohet me racionalen, Grekët me të vërtetë mund të arrijnë larg”.

d-r Katerina KOLLOZOVA



Marrëveshja me Greqinë e mundëson përcaktimin politik të identitetit

Marrëveshja e Prespës mundëson që identiteti nacional të përcaktohet në terminë të pastra dhe të qarta politike, pa atavizma historike-romantike, gjegjësisht, të përcaktohet mbi parimin e përcaktimit të vetënjohjes



Kur bëhet fjalë se identiteti i Maqedonasit është disi i rrezikuar me Marrëveshjen e Prespës, unë me muaj publikisht pretendoj dhe shpjegoj se jo vetëm që nuk është i rrezikuar, por, përkundrazi, me këtë Marrëveshje, identiteti i komunitetit etnik maqedonas në Republikën e Maqedonisë është i ruajtur. Me këtë nuk i konsideroj shprehjet e mia private në Fejsbuk ose Tuitër, por flas për punime, kolumna të botuara këtu dhe jashtë vendit, nga të cilat disa edhe në Greqi.

Në periudhën e kaluar, çdo herë gjatë debatit për këtë çështje, kundërshtarët e Marrëveshjes refuzonin në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i diskutojnë pikat e Neni 7 të Marrëveshjes i cili qartë tregon se dy palët kanë të drejtë ta shfrytëzojnë termin në mënyrën e tyre. Kjo nënkupton t'i japin domethënie të veta për historinë e tyre, për trashëgiminë kulturore, për gjuhën si pjesë e asaj që e bën profilin e identitetit.

Me fjalë tjera, Neni 7 mundëson mënyra krejtësisht të ndryshme të shfrytëzohet termi, duke i vendosur domethënie personale. Kjo do të thotë se Neni 7 mbështetet ose është materializim i parimit të vetëpërcaktimit të identitetit. Me këtë, ne për herë të parë me ndonjë nga fqinjët, madje edhe para Bullgarisë, nga Greqia pranojmë njohje të vetëpërcaktimit të identitetit. Me këtë bëhet hap historik nga dy palët në terminë të historive kombëtare në rajon. Për herë të parë, në vend se në terminë historike folklore dhe kombëtare romantike në terminë të pastra politike determinohet identiteti. Kjo marrëveshje mundëson që identiteti kombëtar të ndahet në terme të pastra politike pa atavizma historike romantike, gjegjësisht, të përcaktohet mbi parimin e përcaktimit të vetënjohjes.

Ekzistonte edhe një grup kritikësh që nuk refuzonin ta diskutojnë Nenin 7, por, megjithatë, arrinin të kenë vërejtje. Sipas meje, nga aspekti i identitetit, përparësi e kësaj marrëveshje është Neni



7, dhe vetëm përparësi, e jo mangësi: fakti se pala maqedonase në marrëveshjen mund të përcaktohet si maqedonase në aspektin popull, gjuhë, grup etnik ose komb: termi komunitet etnik të ne është konstitutiv për konceptin dhe për realitetin e kombit. Ne e përdorim termin komb ose kombësi i cili parimisht në ligjvënien tonë veç më edhe në gjuhën angleze përkthehet si komunitet etnik. Neni 7 edhe në atë kuptim na mundëson ta shfrytëzojmë termin maqedonas në mënyrë të pakufizuar.

Kufizimi i vetëm i cili sipas meje nuk është kufizim për kristalizim i përdorimit, është se në kuptimin kombëtar dhe etnik e shfrytëzojmë në mënyrë të kufizuar në territorin e Maqedonisë së Vardarit, ose ajo që më parë ka qenë Republika Socialiste e Maqedonisë. Sipas meje, kjo nuk është mangësi, por është përparësi, sepse në këtë territor në këtë shtet, në atë federatë të Jugosllavisë e kemi formuar këtë identitet nacional. Këtu e ka pranuar definicionin, këtu e ka pranuar gjuhën e standardizuar, këtu ka formuar akademi maqedonase të shkencave dhe artit. Mundësia e kufizimit në histori në këtë territor ose komb, ne na jep pasqyrë të kristalizuar të identitetit me të cilën pakicat në shtetin fqinj do tëmund të identifikohen.

Të mos harrojmë se sundojnë konfuzione të tmerrshme sepse Grekët identifikohen si Maqedonas. Te ata, kjo është një identitet kulturor -rajonat. Arrihet deri te një situatë absurde në të cilën edhe "Ylberi", sllavofonët që quhen Maqedonas, edhe nacionalistët helenë të thonë "Edhe unë jam Maqedonas".

Si të zgjidhet ky konfuzion? Cila është mënyra që njëra të mos e gëlltisë tjetrën që të mos ndodh ndonjë asimilim? Si ndryshe, përveç nëse nuk i mundësohet "Ylberit", asaj pakice sllavofone maqedonase në Greqinë e Epërme të deklarohet si Maqedonas, në kuptim të maqedonasve nga Republika e Maqedonisë. Kjo zgjidhje është patriotike, dhe jo e kundërta. Pikërisht për shkak se



kjo është referenca pas të cilës identifikohemi, shënuesi “Maqedonas” – ka të bëjë me atë referencë të atij grupi njerëzish në atë territor- ne na mundëson kristalizim të identitetit.

Unë mendoj se këto argumente në aspektin e Marrëveshjes janë patriotike, dhe jo kompromise ose “kozmpolite”. E kundërta nga kritikata e periudhës së kaluar.

Ljubço GEORGIEVSKI



Identiteti “Antik” na grindu me fqinjët dhe me bashkësinë ndërkombëtare!

Identiteti maqedonas nuk është i rrezikuar nga përcaktimi - “E Veriut” ose para emrit të shtetit, por nga qasja e maqedonasve etnikë ndaj identitetit të vet. Maqedonasit nën sundimin Osman kanë arritur ta shpëtojnë identitetin me ruajtjen e kulturës dhe traditës...Kane vallëzuar maqedonisht, kanë kënduar maqedonisht, dhe kanë folur maqedonisht...Të shohim se sa ne vetë, sot në Maqedoni kujdesemi për identitetin tonë Maqedonas



Tema me identitetin është çështje e cila mua më fle shumë dhe shumë herë deri tani e kam diskutuar në publik dhe me adresime të ndryshme. Ndoshta ky moment është i mirë për përsëritjen e disa nga qëndrimeve të mia në lidhje me këtë, për të cilat shpresoj se do të kenë ndonjë ndikim në tejkalimin e kësaj situatë të sotme, të cilën mund ta quajmë si situatë krize.

Kur flasim për identitetin, posaçërisht për identitetin maqedonas dhe për pyetjen – a do të ketë ose nuk do të ketë identitet maqedonas edhe më tej, ne nuk mund të mos i kthehemi pak historisë së çështjes së identitetit maqedonas dhe ndryshimin e tij gjatë, t'i marrim parasysh vetëm 100 vitet më parë. Rasti është pikërisht fakti se, për fat të keq, në dekadën e fundit kemi biseduar për identitetin maqedonas në periudhën e disa mijëra viteve prapa, diçka ndaj të cilës unë isha shumë kritik, dhe më në fund, gëzohem që si një ide propagandiste, kjo sot bie në ujë.

A do të mbijetojë identiteti maqedonas dhe a do të bëhet diçka nga ai pas Marrëveshjes në Prespë? Jam absolutisht optimist, mirëpo, ne duhet t'i qasemi problemit në mënyrë objektive.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, në Maqedoni ndodhi një nga ndryshimet më radikale të identitetit të një populli në Evropë, madje edhe në botë, të cilën ne, si dëshmitarë në historinë bashkëkohore mund ta shohim. Përnjëherë, nga ajo që të gjithë ne e dinim, dhe ishte normë mirë e vendosur – se populli maqedonas është pjesë e grupit sllav të popujve, përnjëherësh u shndërruam në Maqedonas antikë! Në diçka të veçantë, në diçka ekskluzive, në diçka që nuk ka lidhje me asgjë në botë, dhe nga kjo thurrëm një përrallë, në të cilën, për fat të keq, shumica filluan të besojnë. Ndërsa ata që ishin bartës të asaj ideje, mendoj se nga arsye të qarta marketingu e keqpërdorën që të fitojnë në zgjedhje.

Gjegjësisht, bëhet fjalë për identitetin e ashtuquajtur antik të popullit maqedonas, për të cilën gjë kam shumë tekste. Ne nuk



jemi maqedonas antikë, nuk duhet nga atje ta marrim burimin tonë, dhe shpresoj se sot, në një diskutim më normal, do të arrijmë në mënyrë më të argumentuar ta mohojmë vetë atë tezë. Përndryshe, kur flasim për atë identitet të rrejshëm, nuk mund të mos them se ky na dëmtoi shumë në marrëveshjet politike me fqinjët, na dëmtoi në marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare, mirëpo, na dëmtoi më tepër neve.

Në nivel psikologjik, ne u ngritëm mbi të gjithë, filluam të hyjmë në ndonjë film se ne jemi qendra e botës, se çdo gjë rrotullohet rreth nesh, se askush nuk mundet pa ne, e në fakt, e shohim se nuk është fare ashtu, bota gjallon edhe pa prezencën tonë... Dhe pa diskutim të veçantë, pa kuazi shkencëtarët që shkruanin libra dhe gjironin filma dokumentarë në këtë temë. E gjithë kjo edhe ishte një kuazi – shkencë e cila, thjeshtë, na bombardoi dhe na shkaktoi pasojë afatgjate e cila besoj se do të zvarritet shumë vite pas këtyre ngjarjeve.

Projektimi i propagandës në këto 11 vite të kaluara, tregonte për njëfarë identiteti të kombit maqedonas dhe identitetit si e kuptojmë sot, së paku dy ose tre mijë vite pas, ndërsa kaloheshin periudhat prej 50 ose 100 vite... Është shumë problematike dhe me të vërtetë krijon problem në vetëdijen e një Maqedonasi, kur vetëdijen tonë të sotme për identitetin maqedonas e projektojmë 2000 vite pas. Kur t'i shohim faktet, puna është ndryshe. Ta marrim Maqedoninë para kryengritjes së Ilindenit në vitin 1903, të shohim se çfarë ka ndodhur me atë identitet maqedonas. Nëse bëjmë një prerje të identitetit të atëhershëm maqedonas, gjegjësisht, të popullsisë sllave, dy tre vite para kryengritjes së Ilindenit, do të shohim një pasqyrë për të cilën duhet hapur të flasim dhe të ballafaqohemi me atë. Do të shohim se masa e dhe e sllavëve Maqedonas në territorin e Maqedonisë etnike deklarohen si çdo gjë tjetër, përveç si Maqedonas. Ka një masë e madhe e Maqe-



donasve që janë transformuar në muslimanë dhe veten e quajnë turqë, dhe ne tepër pak e përpunojmë në mënyrë shkencore këtë pjesë të popullsisë maqedonase, të cilët së pari u islamizuan, e pastaj e merr emrin etnik -Turqë. Kjo është pjesë e tregimit etnik Maqedonas.

Pastaj, shkojmë në një shtresë të patriarkistëve të ashtuquajtur Grekë, të cilët nuk janë për nënçmim, të cilët në atë kohë janë numër prej 300-400 mijë Maqedonas që deklarohen si Grekë. Shumica prej atyre që kanë luftuar kundër maqedonasve, si patriarkistë grekë, kanë qenë pikërisht maqedonas dhe kemi emra të njohur nga ata.

Grupi i tretë janë Maqedonas të cilët nën ndikimin e propagandës serbe dhe patriarkisë serbe, deklarohen si Serbë, kemi enklava të tilla në rrethinën e Strugës, në Poreçe, në Malin e Zi të Shkupit, Kumanovë...Dhe këta janë Maqedonas, por të cilët veten e përjetojnë dhe deklarohen si Serbë.

Dhe në fund, masa më e madhe, të cilën ne sikur turpshëm duam ta pranojmë, deklarohen si Bullgarë maqedonas. Praktiki është, nëse e shohim atë ide revolucionare të VMRO, nëse duam të jemi objektivë, do të shohim se, për fat të keq, kjo VMRO historike edhe në dokumentet në fillim, mbështetet vetëm në Maqedonasit të cilët deklarohen si Bullgarë. Dhe prandaj, në vitin 1902 e kemi librin e Krste Petkov Misirkov "Për çështjet Maqedonase", në të cilën ai qartë dhe pa dyshime tregon – çfarë nëse deri dhe nuk ka pasur komb maqedonas? Ideja e tij është pikërisht kjo, të gjithë Sllavët në Maqedoni të cilët në atë moment deklarohen si Serbë, Grekë, Bullgarë ose Turqë, të quhen Maqedonas. Kjo është baza e tregimit etnik Maqedonas, e identitetit nacional të cilin ne thjeshtë, qoftë në mënyrë propaganduese, qoftë politike, nëse nga ajo që nuk mund të përballemi me realitetin, thjeshtë, duam ta kalojmë...



Çdo kush që në atë kohë ka kërkuar millet nga Perandoria Osmane, nën "secili" nënkuptoj atë që quhej komunitet ose entitet etnik në Jugosllavinë e mëparshme, këtë edhe e fitonte. Edhe vetë Misirkovi në librin e tij thotë: "Unë jam i sigurt se nëse kërkojmë nesër millet maqedonas, Turqit do të na e japin". Megjithatë, kjo nuk ndodh! VMRO, intelijenca maqedonase e asaj kohe nuk kërkojnë millet maqedonas, nuk ka punë të tillë në historinë tonë, nuk ka një letër të atij lloji, nuk ka manifest... Në vitin 1905 mbli-dhen 100 tregtarë vllahë dhe intelektualë, i dërgojnë letër sulltanit dhe sulltani u jep milletin e Vllahëve. Kjo nuk ndodh te populli maqedonas.

Identiteti maqedonas, sipas meje, nuk është i rrezikuar nga përcaktimi "E veriut", ose "E Epërme" para emrit të shtetit, por nga qasja e maqedonasve etnikë ndaj identitetit të vet. Sipas tij, Maqedonasit nën sundimin Osman kanë arritur ta shpëtojnë identitetin me ruajtjen e kulturës dhe traditës.

"Kanë vallëzuar valle maqedonase, kanë kënduar këngë në gjuhën maqedonase dhe kanë folur maqedonisht... Hajde të shohim se sa ne vetë në Maqedoni kujdesemi për identitetin tonë maqedonas. Të vizitojmë një dasmë maqedonase, në festë maqedonase, ju siguroj se kombi bashkëkohor maqedonas dhe shteti bashkëkohor maqedonas janë të vetmit në Ballkan, ku kënga kombëtare është pakicë në krahasim me ndikimet tjera kulturore. Ne asgjë nuk veprojmë flasim për identitetin maqedonas, ndërsa kur duhet të festojmë një dasmë, ditëlindje ose ditën e emrit, ne nuk e këndojmë këngën maqedonase, dhe pastaj flasim se dikush tjetër e na e rrezikon identitetin maqedonas. Jo, ne vetë e rrezikojmë.

Me qindra e qindra Maqedonas, në diasporë, kur shkoja në fillim kur duhej ta krijojmë shtetin Maqedonas, si pyetje kryesore që ma parashtronin ishte – pse duhej të paguajnë nga 50 dollarë



për pasaportë maqedonase? Ata janë njerëz që flasin për Maqedoninë, të cilët e kishin rëndë të paguajnë, dhe mendoj se deri në ditën e sotme ky problem zvarritet në shumë diskutime të diasporës maqedonase, kur duhet të japin nga 50 euro ose 50 dollarë që të marrin pasaportë Maqedonase...

Të shkojmë më tutje, shumica nga ata duhet të pyeten se pse pas 15 vite nuk janë kthyer në Maqedoni. Do të vijnë në Maqedoni kur do t'u vdes babai ose nëna, që t'i varrosin, dhe përsëri, 15 vitet e ardhshme zhduken. Çfarë ndodh me mos pagëzimin masovik me emra maqedonas të fëmijëve në diasporë? Dhe në fund, çfarë po ndodh me mos mësimin e gjuhës maqedonase? Unë ju siguroj se në këtë moment, 50% të fëmijëve të gjeneratës së parë Maqedonasve në diasporë nuk e dinë gjuhën maqedonase, e të mos flas për gjeneratën e dytë... 99% nuk e dinë gjuhën maqedonase!

Dhe në fund, me të vërtetë për argumentet se shtesa e tipit – E Veriut, është e dëmshme. Nuk ka asnjë dëm dhe nuk ka asnjë reperkusion për mbrojtjen e identitetit maqedonas dhe për pyetjen – a do të jetë identiteti maqedonas. Thjeshtë, sipas meje, kjo nuk është çështje për diskutim. Shumë herë jam shprehur për këtë çështje, shumë herë kam thënë se çështja e identitetit është diçka që vetë duhet ta mbrojmë, dhe vetë ta bartim.


Të mos flasim për shembujt me emrat të cilat i kam përmendur shpesh. Shembulli me Kosovën fqinje, populli është Shqiptar, pjesërisht Serb, mirëpo ta shohim atë shqiptarin si bartës, ata në asnjë moment nuk mendojnë se emri Kosovë është problem për identitetin e tyre. Dua të përkujtoj edhe në fqinjin tonë verior, Serbinë, kur të gjitha republikat u shkatërruan dhe mbeti vetëm ajo të jetë Jugosllavi, mendoj se 6-7 muaj emri ishte Jugosllavi, populli ishte Serb, por kishte diskutim të mbahet emri Jugosllavi.

Identiteti është diçka shumë më burimore, është ndjenjë të cilën askush nuk mund ta rrezikojë nëse e ke shtetin tënd. Edhe



mua më vjen keq që çështja e identitetit që është çështje minore, u bë problem i Maqedonasve në Maqedoni. Të themi në Turqi – Kurdët luftojnë për shpëtimin ose mbrojtjen e çështjes së pakicës, në Maqedoni pyetjen mund ta parashtrojnë të gjitha pakicat – vetëm jo, populli Maqedonas – a është mjaft i mbrojtur identiteti, a kujdeset shteti për këtë identitet, a ka asimilim politik..., këto janë pyetjet për identitetin.

Kjo çështje na vendos në një gropë të thellë nga e cila nuk mund të dalim. Dhe rrotullohemi 30 vite rreth kësaj çështje. Vërej, ende ka shumë fuqi politike që binden këtë çështje ta mbajnë në jetë, përsëri me temat dhe tregimet tjera... Ndërsa, në esencë, kjo është vetëm një mohim i identitetit individual.



Diana TAHIRI



Identitetet e mia nuk janë vetëm përqindje e nevojshme

Më tepër se çdo gjë, më pengon kur identiteti im gjinor, etnik dhe intelektual shfrytëzohet për përfaqësime përqindjesh në raste të caktuara. Sepse qenia njerëzore në thelb është përbërje e shumë identiteteve, të cilat me ndërthurjen e tyre brenda në njëriun, si fizik, si qenie intelektuale, përbëjnë një tërësi. Kur ajo tërësi ndahet, gjegjësisht, kur nga ajo tërësi shfrytëzohet vetëm një pjesë, për nevoja utilitare, duke i lënë anash pjesët tjera të asaj tërësie, atëherë fitohet vetëm një pasqyrë, përgjigje, lëvizje, cilësi e pjesërishme, pa shkëlqyeshmërinë që e mban në vete një qenie njerëzore e plotë.



Shpesht mendohem në drejtim të identiteteve që i posedoj. Si snjeri, grua, nënë, shoqe, kolege, punëtore, amvise dhe për disa identitete etnike të cilat thuren në qenien time në këtë vend.

Quhem Diana, mbiemrin e kam Tahiri. Mbiemri im i vajzërisë është Jumeroviq, i nxjerrë nga mbiemri Imeri, gjatë kohës së luftës së parë botërore, që ka vazhduar të jetë në atë formë edhe pas luftës së dytë botërore, e pastaj në sistemin komunist. Diku pranë fundit të sistemit komunist në Jugosllavinë e atëherëshme, njerëzit filluan t'i kthejnë mbiemrat autentikë, nga "ski", "viq" ose "ov", varësisht nga pozita gjeografike e qëndrimit të paraardhësve të cilëve ua kishin ndryshuar mbiemrat, me qëllim asimilues. Unë nuk arrita ta ndryshoj mbiemrin, sepse u martova, dhe pa u menduar shumë e pranova mbiemrin e bashkëshortit tim. Nuk e ndryshova mbiemrin as pas vdekjes së tij, sepse nuk doja t'i shkaktoj edhe më tepër huti vajzës sime e cila ishte në moshë shumë të vogël kur mbeti pa një prind.

Mbiemri im me "përcaktim" serb – "viq", personalisht, nuk më ka shkaktuar ndonjë huti ose pasiguri në kuptimin e identitetit. Identiteti im etnik, nga babai dhe nëna, është shqiptar, i përzier edhe me disa tjerë nga ana e babait tim. Asnjë identitet tjetër, përsëri këtij, zyrtarit, me të cilin paraqitem kur kërkohet nga unë, dhe paraqitem me shkrim dhe gjuhën me të cilën komunikoj me familjen time më të ngushtë, asnjëherë nuk ka paraqitur ndonjë kërcënim për të dytin, të tretin...

Megjithatë, në shoqërinë në të cilën jetoj, nuk është aq thjeshtë. Gjatë jetës sime të deritanishme, identiteti im – Shqiptare, shesh nuk është pranuar, sepse, nuk kam ngjarë si Shqiptare. Nga Shqiptarët, me të cilët e ndaj identitetin, gjithashtu kam pasur mospranim të identitetit, për ata gjithashtu shpesh nuk i ngjaja një Shqiptareje, dhe kjo ka të bëjë me stereotipet e zhvilluara në të gjitha komunitetet në Maqedoni. Për shembull, kur u regjistrova në shkollë të mesme, vendosa të mësoj në gju-

hë maqedonase. Në ditën e parë të mësimi, u takuam të gjithë nxënësit e klasës, dhe pasi kuptuan se jam shqiptare, disa nxënës më rrethuan dhe më parashtruan pyetje shumë interesante dhe qesharake. A jam e zezë nga lindja, ose kam qenë në det... “sepse ju nuk shkoni në det, apo jo?”. Ose, a punon nëna ime, dhe kur u tregova se punon, më pyetën se si vishet kur shkon në punë. Nuk durova pa bërë shaka me përgjigjen time: “Ka dimi të veçanta. Nga një palë për çdo ditë”. Më vonë kuptova se shumica e nxënësve të klasës asnjëherë nuk kanë pasur kontakt me ndonjë shqiptar gjatë jetës, prandaj edhe kishin pasqyrë të gabueshme se si duket një shqiptare ose shqiptar, gjegjësisht, nuk kishin fare pasqyrë, por se pasqyrën e kishin të përcuar. Gjatë vijimit katërvjeçar të shkollës së mesme, u shoqëruam shumë, pa përjashtime. Madje erdhën edhe në shtëpinë time si mysafirë, nga kureshtja, që më pas të kuptojnë se jetojmë, sillemi, ushqehemi, bëjmë çdo gjë në mënyrë të ngjashme, përveç se flasim në gjuhë të ndryshme. Këto gjëra nuk më penguan në formimin tim në person të pjekur dhe të sigurt, përkundrazi, madje më ndihmuan.

Mirëpo, me siguri se më pengon kur dikush, në vendlindjen time, më quan pakicë, minoritet. Sepse sipas bindjes sime, askund në botë nuk duhet të ketë pakica, kur bëhet fjalë për identitetin njerëzor. Mendoj se numri administrativ nuk duhet ta përcaktojë statusin e një populli në një shtet të caktuar. Imagjini Evropën si një shtet, dhe dikush në atë shtet vazhdimisht t’u quajë minoritet, t’ua fërkojë hundën me të drejta të cilat vazhdimisht ti jep, sepse si komunitet me numër më të vogël, sikur është rregull se duhet t’i meritoni, dhe të jeni në mëshirën ose (jo) mëshirën e dikujt. E zgjedha Evropën si shembull, sepse trendi i sotëm është anëtarësimi në këtë bashkësi të madhe, me shumë lëshime nga ana e vendit tonë, plotësime dhe detyra të kryera ndaj këtij përcaktimi, me qëllim përfundimtar, barazi mbi



të gjitha bazat. Imagjinoni se si ndjehemi ne, tjerët, në shtetin tonë të përbashkët...

Sa i përket asaj nëse me anëtarësim në BE, bashkëqytetarët e mi Maqedonas do ta humbasin identitetin e tyre, jam e bindur se nuk do ta humbin. Sido që të quan dikush, çdo herë do të mbetesh ajo çfarë je. Çdo herë kam luftuar kur më kanë sulmuar njërin nga identitetet e mia, çdo herë ka dikush që i pengon identiteti tjetër, kur bëhet fjalë për identitetin etnik, sepse për momentin bëhet fjalë pikërisht për atë etnik.

Më tepër se çdo gjë, më pengon kur identiteti im gjinor, etnik dhe intelektual shfrytëzohet për përfaqësime përqindjesh në raste të caktuara. Sepse qenia njerëzore në thelb është përbërje e shumë identiteteve, të cilat me ndërthurjen e tyre brenda në njeriun, si fizik, si qenie intelektuale, përbëjnë një tërësi. Kur ajo tërësi ndahet, gjegjësisht, kur nga ajo tërësi shfrytëzohet vetëm një pjesë, për nevoja utilitare, duke i lënë anash pjesët tjera të asaj tërësie, atëherë fitohet vetëm një pasqyrë, përgjigje, lëvizje, cilësi e pjesërishtme, pa shkëlqyeshmërinë që e mban në vete një qenie njerëzore e plotë.



Të ndërtojmë shoqëri në të cilën të gjithë do të jemi qytetarë të Evropës !

Nëse dëshiroj të zgjedh ndonjë identitet, edhe pse identiteti im veç më është i formuar, unë, megjithatë, zgjedh të kem identitet të pavdekshëm. Identitet të cilin askush nuk e sjell në pyetje, identiteti i njerëzimit, i humanitetit, të jesh moment pozitiv në një shoqëri, të kontribuosh...



Në kornizat e gjithë asaj që po na ndodh në Republikën e Maqedonisë dhe qll e brengos qytetarin e rëndomtë, mendoj se identitetin tim për momentin e përjetoj si qytetare e cila paguan tatime, e cila nuk i shkel ligjet, ndoshta ndonjë të imët, për parkim të gabueshëm, qytetare që i paguan të gjitha tatimet e mundshme, dhe pasi jam pronare e një kompanie, paguaj edhe tatim të fitimit, dhe qytetare e cila nuk e ka problem të paguajë tatime derisa nga shteti ndahen mjete për ndihmë sociale, qytetare e cila nuk e ka problem pensionin e moshës për persona mbi 65 vite... Të gjitha këto karakteristika, si qytetare e Maqedonisë, më bëjnë të marr pjesë në krijimin e Maqedonisë në një vend më të mirë, duke e bërë një vend më të mirë për jetë, vend në të cilin do të ketë kushte për jetë për të rinjtë, të moshuarit, për të gjithë...

Mendoj se për identitetin gjëja kyçe është – të mos i shkelni, por ti respektoni ligjet e Maqedonisë. Në aspektin e debatëve tjera, se si njerëzit e kuptojnë identitetin lidhur me etninë përkatëse, kam shkruar edhe për Civilin. Në temën – cili është identiteti im, mund të them se reflektoj një pasqyrë të mrekulueshme për Maqedoninë, si vend i kulturave, popujve dhe kombeve të ndryshme... Kemi myslimanë Maqedonas të cilët identifikohen si Torbeshë dhe Goranë, varësisht nga zona e prejardhjes, ose, si gjyshet e mia që janë endur në kornizat e Jugosllavisë dhe kanë ardhur të jetojnë në Maqedoni...

Debati në Maqedoni në kuptim të Marrëveshjes së Prespës me të vërtetë krijoi hapësirë – njerëzit të marrin të drejtën të tregojnë se kush ka, e kush nuk ka të drejtë të bisedojë për identitetin në kornizat e kësaj marrëveshje... Një pjesë e madhe e komunitetit tim etnik, boshnjak, ishim të etiketuar se nuk kemi të drejtë të bisedojmë për identitetin maqedonas. Përsëri kthehemi në pyetjen: kush ka të drejtë të negociojë ose, a është identiteti diçka për të cilën mund të negociohet, ose, a është kjo ndonjë ndjenjë që ne e kemi brenda në vete? Unë kam lindur në Maqedoni, por identiteti



im si përkatëse e komunitetit boshnjak nuk ndryshon, sepse me këtë identitet jam rritur, në shtëpi e flasim gjuhën boshnjake dhe këtë ndjenjë nuk e ndryshoj, edhe pse rrallë shkojmë atje prej nga rrjedhim, në Serbi.

Në kuptim të reflektimit të Maqedonisë, kam ngjarje interesante gjatë udhëtimeve në vendet ku popullsia është me dominim mysliman. Kisha profilim të veçantë në aeroport, me siguri për shkak të dukjes time, nga i cili duket qartë identiteti im fetar, më mbajtën dhe më dërguan në dhomë të veçantë që të më pyesin cila jam, çfarë jam, çfarë kërkoj në atë shtet... Ishte e mjerueshme që nuk e dinin gjuhën angleze, kështu që ftesa për konferencë nuk më bëri punë. E revoltuar, pyeta: pse më mbani, pse më sollët këtu? Nuk u përgjigjën, nuk dinin anglisht dhe e gjithë ajo zgjati 15 minuta... Diçka të ngjashme përjetoi edhe në aeroportet evropiane, në të cilat siguria është e ngritur në nivel më të lartë. Në ato 15 minuta më rrotullohet në kokë një mendim: "Tepër e bardhë të jem myslimane, tepër myslimane të jem qytetare e Evropës".

Definitivisht, kjo është diçka me çfarë vazhdimisht përballeni me atë nevojë për përkatësi, ky identitet të jetë gjëja kyçe që do t'u definojë dhe të gjithë t'u shohin përmes atij identiteti. Me të vërtetë, kjo vetëm do ta bëjë më të rëndë funksionimin në një shoqëri normale e cila pretendojmë të jemi. Nëse unë dëshiroj të zgjedh një identitet, edhe pse identiteti im veç më është i formuar, unë megjithatë do të zgjedh identitet të pavdekshëm. Identitet të cilin askush nuk do ta sjell në dyshim, identitetin e njerëzisë, humanitetit, të jesh moment pozitiv në shoqëri, të kontribuosh.

Ky është identiteti të cilin askush nuk do t'ua shkel ose rrezikon. Me "dilema" – a je "tepër e bardhë të jesh myslimane", humbim shumë kohë produktive, shumë energji dhe hyjmë në debate se kush ka të drejtë, e kush jo, a të dal në referendum, ose, cila jam unë të bëj thirrje për dalje në referendum, cila jam unë të bëj pazarllëqe me emrin etj... Të gjitha këto momente janë



humbje kohe, në vend se të fokusohemi në ndërtimin e shoqërisë konstruktive dhe ndërtimin e identitetit i cili me të vërtetë do ta pasqyrojë Maqedoninë, ashtu si është. Shoqëri me shumë kultura, multietnike, multifetare...Me të gjitha këto "multi" para vetes, ne, për fat të keq, u kthehemi problemeve rrënjësore për atë se kush jemi dhe çfarë jemi...

Ajo që ishte interesante në aspektin e debatit për referendumin është që në partinë opozitare kemi edhe të tillë që nuk i takojnë grupit etnik maqedonas. Një nga ata përfaqësues është përkatës i grupit tim etnik, boshnjak, dhe ishte i madhëruar si hero, i cili votoi për ndryshimet në kushtetutë. Komentet ishin: "Si është e mundur, tradhtar!" Çdo herë komunitetet tjera etnike janë tradhtarë...Dhe përsëri ndjenja se, nëse je përkatës i një grupi, dhe dëshiron të jesh pjesë e atij grupi, duhet ta kesh atë mejnstrim të mendimit dhe sjelljes...Nuk pranohet diçka që është e ndryshme, si mendim, etni, ose komunitet...

Unë mendoj se është në rregull të ketë parti të pastra etnike sepse votuesit këtë e duan, retorika para zgjedhjeve është e mprehur në aspektin e momenteve etnike. Mirëpo, unë angazhohem për ide të konceptit qytetar dhe ide të identitetit, ku çdo kujt do t'i lejohet të zgjedh vet dhe të ndjehet ashtu si dëshiron. Secilit në Maqedoni, që kontribuon, që investon, e dashuron...Për mua, kjo është e rëndësishmja në këtë tregim.


Ndoshta kur kritikojmë në debate publike dhe konferenca, duke dashur që sistemi të jetë më i mirë, dëshirojmë të flasim për Maqedoninë para bashkësisë ndërkombëtare – në dritë shumë më të mirë. Dhe kur flasim për identitetin, shpresoj se të gjitha komunitetet etnike do të ngritën mbi identitetin tonë primar. Dhe, se të gjithë do të ndërtojmë një shoqëri e cila me të vërtetë do të jetë më e mirë për jetë dhe se do të fitojmë epitelin se ne jemi – qytetarë të Evropës

Në aspektin e ngjarjeve në botë, ishte interesante të dëgjohet



përfaqësuesja e re në Kongresin në SHBA, e cila është me prejar-dhje nga Somalia. Ajo theksoi: Unë vij me shumë “të para”, jam refugjatja e parë, myslimania e parë me mbulesë në Kongres dhe gruaja e parë me ngjyrë tjetër, e cila do ta përfaqësojë shtetin e vet...

Derisa në botë ndodhin shumë gjëra të para dhe revolucion-are, për fat të keq, ne këtu kthehemi në vitet 1903, 1906 dhe të gjitha ato njëmijë e nëntëqinda vite, ndërsa realiteti është tani, jeta që e jetojmë është tani... Shpresoj se identiteti është vetëm rast dhe mënyrë të jemi të ndryshëm, të njihemi, të shoqërohemi, të pranohemi, dhe jo të ndahemi.



Vojo MANEVSKI

Identitet “A la Shtip”

Në aspekt të identitetit, jemi në gjendje si Hebrenjtë para Krishtit. Vazhdimisht presim ndonjë Profet, të na paraqitet lider partie i cili do të na e tregojë rrugën, qeveri që do të na hap vende të reja pune, Evropë që do të na sjell shumë para, e ne nuk do të punojmë...





Maqedonia ka 4000 profesorë universitarë, nuk e di sa doktorë shkencash, dhe vlerësoj se ko hapësirë shkencore është e zënë, ndërsa ne me të drejtë presim nga ata zgjidhje për problemet shoqërore... Unë punoj në televizion lokal, jetoj dhe jam i lindur në vendin e quajtur Novo Sello. Kjo është një pjesë e Shtipit, nga i cili më vonë është ngjitur pjesa tjetër e qytetit. Nuk e di nëse Shën Pjetri ka shkruar në letrat e tij për Shtipin, ose Aminta i 3, ose nuk e di cili e ka përmendur, por ekziston së paku 100 ose 1500 vite.

Për shkak të moshës sime, shkoj herët në punë, ndërsa në këto ditë vjeshte dhe dimri, mëngjeset janë të errëta...Por, do t'ua tregoj atë që u në e shoh si identitet të bashkëqytetarëve të mi. Së paku të atyre me të cilët takohem dhe qëndroj çdo ditë. (Prandaj them se nuk kam qëndrim por "vend të uljes", sepse atë që unë e shoh, e bëj nga pozita e ulur në kafenetë e vjetra në të cilat nuk ka karrige të gjata, të cilat më duket mjaftë "alpiniste" që tu hip mbi, por edhe nuk më ngjan...)

Puna e parë me të cilën kam problem në mëngjes, është ti shmangem gurit të bardhë të shtëpisë së lindjes së kryepeshkopit Mikail. Aty shkruan " shtëpi në rrënim", kështu shkruan së paku 20 vite, ndërsa edhe kryepeshkopi me siguri është pjesë e ndonjë identiteti. Nëse asgjë tjetër, në atë rrugë...E kaloj urën, dhe si mes hijeve të Ballkanit, kalon mes shtëpive mbi të cilat shkruan se janë ndërtuar në vitet 1826, 1827, 1828... e kështu me radhë. Pasi u interesova se si këta njerëz kanë arritur të ndërtojnë shtëpi që ngjajnë se ato të "Le Corbusier" në Krushevë, kuptova se ata njerëz kanë qenë tregtarë me opium. Kështu që, sipas fjalorit modern, identiteti i tanishëm do të ishte – narko kartel, vetëm se kjo është para 200 viteve...Megjithatë, kanë ndërtuar dhe një kishë patriarkale.



Kur kaloj andej, patjetër kaloj përreth shtëpisë së rindërtuar të familjes Mijallkovi (në të vërtetë pak e zgjeruar, por edhe kjo është identiteti i kësaj kohe) ose shtëpisë së lindjes së nënës së Kryeministrit të mëparshëm...Menjëherë afër asaj, disi si më lartë, por kanë mbetur vetëm gurë, është shtëpia e lindjes së Vanço Mihajllorit. Edhe shtëpia e Todor Aleksandrovit, nga e cila ka mbetur vetëm ndonjë gur. 50 metra më djathtë është shtëpia e lindjes së, me siguri Maqedonasit më të njohur jashtë Maqedonisë, edhe pse te ne nuk dihet shumë për atë. Është profesori i etikës Todor Popov, regjenti i mbretërisë Bullgare dhe një nga bashkëpunuesit e Sartrit. Personazh i madh, por shtëpia e tij pothuajse e tëra është e rrënuar. Nuk ka kush si ta shënojë disi. 10 metra më larg është shtëpia e Mihajllo Apostollskit. Edhe atje, me qiri mund të zbulosh ndonjë shënim...Nuk ka asgjë. Dhe kjo është pjesë e atij identiteti për të cilin sot dëshirojmë të themi se e kemi trashëguar...

Edhe shtëpia e Çuçkovit, themeluesit të Fakultetit ekonomik dhe i "Tanec", gjithashtu nuk ka asnjë shenjë... Dhe shumë tjera. Është interesante se bashkëqytetarët e mi, fqinjët e me, 90% nga ata, nuk dinë gjë për këto, por e dinë se aty ka lindur nëna e kryeministrit të mëparshëm. Flasim për identitetin, a po jo... Ashtu siç e kemi kuptuar ne, në mënyrë provinciale.

Pse them se dua ti vështroj bashkëqytetarët e mi, si pjesë e atij identiteti maqedonas. Shtipi ka një identitet interesant, së paku si të trashëguar. Feldmarshalli gjerman Levinski, pasi ka qenë në Shtip, ka shkruar: "Kjo kasaba orientale është e përbërë nga gjysma muhamedanë, gjysma të krishterë ortodoksë dhe Hebrenj". Sot janë 95% Maqedonas ortodoksë. Bashkëqytetarët tonë të mëparshëm i ka marrë historia. Dhe ky është identiteti i trashëguar.



Si i njoh bashkëqytetarët e mi? Kështu, ka një kafene e vjetër, quhet "Kaj Çiçko Zaki" ("Te Xha Zaki"), nuk është e privatizuar, sepse ka qenë private qysh në vitet 60, kështu që nuk e morën turbulencat. Atje ulen "deputetët". Pse deputetë? Ata vetë quhen ashtu, sepse në mëngjes i përcjellin nga shtëpia, t'i dërgojnë nipërit, fëmijët ta kontrollojnë listën pozitive të ilaçeve nëpër barnatore...Te ata është interesante se ata pinë vetëm kafe turke me llokum dhe ujë, lexojnë gazeta...

Te ata vërej se çdo herë i kanë këpucët e pastra, mirë të shndritura, nuk bëjnë shumë zhurmë, edhe pse kafeneja është formë demokratike dhe aty mund çdo kush të bëjë zhurmë, janë të veshur mirë, si klasë e mesme evropiane nga vitet e shtatëdhjeta, mund të shihni se kanë veshur xhaketa nga Murska Sobota, ndoshta kate nga Varazhdini, të ruajtura... Është interesante se janë të arsimuar. Këtë arsimim e krahasoj me përvojën e një kohe tjetër, kanë arsimim enciklopedik...

Uleni me ata të bisedoni dhe ata flasin për drejtime tjera, jo për modernet, sepse bëhet fjalë për njerëz që kanë lindur në vitet e 50. Dhe të gjithë ata, si lajtmotiv e kanë: "Çdo gjë është e mbrapshtë". I dinë të gjitha komplotet botërore. Dhe, kuptohet, çdo gjë është mbrapsht sepse koha në të cilën ata e kanë arritur zenitin e tyre, nuk ka qenë e tillë, sipas rregullave të sotme. Dhe para vetes, pothuajse çdo i dyti, ka nga një pusullë të vogël, në të cilën shkruan "Merr tre bukë..."

Është interesante se atje mund ta takoni edhe poetin Samonikov, mund të takoni edhe profesorë universitarë, të cilët menjëherë do t'u thonë: "Flasim për politikë ekonomike, e shumica nga ju asnjëherë nuk e keni lexuar të lartpërmendurin Emanuel Çuqkov". Ose: "Flasim për demokratizimin në shoqëri dhe për

paratë, e një Aleksandar Grliçkov ka shkruar një ndër veprat më të njohura për sistemin e delegatëve si shprehja më e mirë e demokracisë"... Të gjithë këta njerëz janë ata për të cilët pretendojmë të jenë pjesë e identitetit tonë. Por, e përsëris, është një përqindje e vogël e njerëzve që flasin për ata.

Gjenerata e dytë e bashkëqytetarëve të mi del nga ora 11-11:30 të paradites, dhe ulen në ndonjë nga kafenetë e kombinuara, piceri, kafe...nuk e di më se si quhen. Interesante te ata është se të gjithë janë me përcaktime politike, të gjithë janë anëtarë të partive, sepse me inerci kanë vazhduar nga Bashkimi i Komunistëve të jenë anëtarë të LSDM, ose ata tjerët që janë bërë anëtarë të VMRO, në numrin më të madh, kuptohet... Ajo që unë e vërej mes tyre, është se diskutimet politike janë si ato të ditës së hënë, pas ndeshjeve të mëdha sportive. Ata nuk urrehen mes vete, bëjnë shaka – ju fituam, nuk na fituat, por kanë një dozë të mirë të respektit të ndërsjellë. Kjo është gjenerata e rokerëve e cila mban atlete ende, nga dy arsye. Arsyeja e parë është se kur kanë filluar të shkojnë në korzo ka qenë simpatike të mbahen atlete. E dyta? Sepse të rinjtë kryesisht blejnë atlete të shtrenjta, ndërsa nuk merren me sport, dhe nuk i mbajnë më, e prindërit i mbathin. Kështu që, kur ndonjëri prej tyre nisët për në toalet, mund të shihni edhe atlete fosfori, me ato që shëndrisin. Kjo mund të duket e papërshtatshme, por kjo është pasqyra e identitetit të kësaj gjenerate të bashkëqytetarëve të mi në këtë moment...Janë të mësuar me këto, telefonat e ri, sepse nëse dëshirojnë t'i dëgjojnë fëmijët dhe nipërit e mbesat, duhet të përdorin skajp, koha është e tillë, dhe nuk është lehtë të qëndrosh me ata, sepse, janë të hidhur. Por, tolerantë...

Gjenerata e tretë janë fëmijë të tranzicionit, të lindur diku pas viti '75. Për ata them se kanë tepër pak ideologji, ndërsa për moral



dhe tjera, le të flasin kritikët. Për ata vlen maksima: "Shfrytëzoje çdo rast tani!" Pa përjashtim janë anëtarë të partive, i zënë vendet nëpër shtabe. Të mos ua zë dikush vendin, që të arrihet deri në vend pune, avancim...Nuk mendojnë për atë që u ka dërguar shefi nga Shkupi, nëse është e drejtë ose jo...Viktima të tranzicionit... Çfarëdo që bëhet për shoqërinë, për ata është e arsyetuar, sepse kanë një shprehje shumë të mirë "Gjindu!". Është interesante kur bisedon me ata, zakonisht thonë se përvoja e tyre, në moshë 35-40 vjeçe, u tregon: "Ma trego një si ti, nëpunës, me makinë të shtrenjtë". Dhe shumë vështirë u përgjigjet, sepse janë dëshmitarë edhe të tranzicionit në të cilin janë rritur, dhe për dallim nga gjeneratat e rokerëve dhe atyre paraprakeve, të shllagerëve, sipas meje, janë të arsimuar ngushtë. Nuk kanë dituri enciklopedike, por kanë dëshirë të madhe për pasurim. Kështu e kuptojnë shoqërinë liberale, liberalizmin postmodern, kështu e kuptojnë Evropën, për shijen time, me shumë formalizëm. Për ata është me rëndësi të jenë magjistra, doktorë...

Me gjeneratën e fundit nuk shoqërohem shumë për shkak të numrit të letërnjoftimit tim. Këta fëmijë mbajnë televizorë që quhen telefona, bisedojnë tërë ditën përmes tyre, kthehen rreth ora 5-6 pasdite, nuk komunikojnë mes vete, me siguri komunikojnë përmes rrjeteve sociale, pinë makiato, me lugë plastike që e mbajnë në gojë...Dhe ajo që mund ta dëgjosh nga ata është: "Unë nuk e gjej veten këtu". Studiojnë për të studiuar, nuk mendojnë për asgjë tjetër, përveç se si shoku i tyre ka fituar 2.500 euro nga puna në Gjermani, ndërkohë zgjohet në ora 11. Rreth 11,30 Pitu Gulin veç më e kanë vrarë...por, të mos i ofendoj

Përshtypja ime, në fundin e kësaj dekade të pestë si njeri, në aspektin e identitetit, është se jemi në gjendje si Hebrenjtë para Krishtit. Vazhdimisht presim ndonjë Profet, të na paraqitet lider

partie që do të na tregojë rrugën, qeveri që do të hap vende pune, Evropë që do të na sjell shumë para, e ne nuk do të punojmë... Nuk e di nëse do të vjen Profeti, por ja, ju ftoj të shihni se si jetojmë ne në provincë, si jetojnë këta bashkëqytetarë të mi të cilët tentova ti pikturoj.





Kultura dhe tradita janë më të rëndësishme për përkatësinë e dikujt, sesa vetë emri!

Pse do të dëshiroja, për shembull, t'i ndaj vlerat e shtetit Maqedoni. Ato qëndirme nacional -romantike, dhe në të cilin ke lindur – është atdheu yt. Unë kam lindur në Slloveni, dhe përveç faktit që kam lindur në Slloveni, nuk kam ndonjë marrëdhënie intime me atë shtet, gjegjësisht, kam sikur ndaj të gjitha shteteve tjera. Pse do të duhej të kem qasje intime ndaj Maqedonisë? Por gjithsesi, deklaro hem si Maqedonas, tento j të jetoj jetë të mirë në këtë shtet, që nënkupton se përpiqem të siguroj kushte të mira edhe për tjerët rreth meje dhe të krijoj më ndonjë vend të mirë, të përshtatshëm për jetesë...



Çështjet e identitetit çdo herë janë të çuditshme, posaçërisht çështja e humbjes së identitetit, jo vetëm për shkak të ndonjë substance retorike që e përmban vetë çështja. Sidoqoftë, më habit edhe më tepër ftesa të flas për këtë temë në një moment të ndjeshëm dhe të rëndësishëm, gjegjësisht, në momentin e vdekjes së një njeriu të afërt. Kjo më bëri të mendoj në mënyrë ndoshta pak më filozofike dhe të mendoj - Kur e humb njeriu identitetin e tij në të vërtetë? Atëherë kur varroset në varreza, ose ndoshta qysh gjatë sëmundjes së tij kur ndryshon fiziku dhe psikologjia e karakterit të tij? Ose, ndoshta identiteti i tij mbijeton edhe pas vdekjes së tij përmes tregimeve, shkrimeve të tija ose shkrimeve për atë? Dhe, çfarë lidhje ka kjo me shtetin, kombin, përkatësinë etnike me zhdukjen tonë të pashmangshme biologjike.

Isha pjesëmarrës në një ngjarje të quajtur “Letërsi e gjallë”, në të cilën disa shkrimtarë tentonin aty për aty të bëjnë një farë letërsi të folurit ose fikcion të të folurit. Ylli i festivalit ishte shkrimtarja kroate Sllavenka Drakuliq, ndërsa tema ishte “... ime e mëparshme”. Shkrimtarja vendosi të flet për shtetin tonë të mëparshëm, Jugosllavinë. Ajo i preku çështjet e identitetit, duke e krahasuar shtetin e saj relativisht të ri – Kroacinë, me shtetin e saj amë ose shtetin e parë Jugosllavinë, me problemet e lirisë së shprehjes, të lëvizjes, me hapësirën e kufizuar, integritetin territorial.

Unë fola për Jugosllavinë, jo për shtetin tim të mëparshëm, por për cigaren time të mëparshme, për filter “Jugosllavija”. Unë i preka çështjet e identitetit përmes rastit të këtyre cigareve. Filter “Jugosllavija” është cigarja e parë filtër në Jugosllavi dhe prandaj e mban këtë emër. Është emri i parë sintetik i cigareve në Jugosllavi, sepse të gjitha cigaret para asaj janë me emra gjenerikë, gjegjësisht të gjitha atë lumenj – Morava,



Vardar, Drava, Drini..., në fakt janë emra të llojeve të industrisë së duhanit në Jugosllavi, të prodhuar në Prilep.

Në vitin 1998, një nga vendimet e para të Qeverisë së Ljubço Georgievskit ishte të ndërpritet prodhimi i filtër “Jugosllavija”. Ishte vlerësuar se një numër relativisht i vogël e konsumojnë këtë cigare dhe se goditja ekonomike nuk do të jetë serioze, dhe në vend të këtyre filloj të prodhohet filtër “Makedonija”, që do të thotë se – disa përfitime politike do të ishin më të forta nga humbja ekonomike që do të pasonte me ndërprerjen e cigareve. Pikërisht atëherë, ose pak më vonë, u ndërpre edhe prodhimi i filtër “Evropa”. Nga këto emra gjeografikë, në treg mbetën vetëm filtër “Makedonija”. Mirëpo, çfarë ndodhi? Filter “Makedonija” ishte cigare me një identitet tjetër, të veçantë, edhe vizual, krejtësisht tjetër nga “Jugosllavija”, dhe duhanpirësit e “Jugosllavija” refuzuan ta konsumojnë.

E mbaj mend se si endesha, si pa kokë, nga MT, “57”, “Rodeo”, duke kërkuar diçka që përfaqëson ngjan si “Jugosllavija”. Nga ana tjetër, “Makedonija” ishte njëjtë si “Jugosllavija”, e punuar nga duhani i zi, cigare e lirë e cila nuk mundej t’i tërheq duhanpirësit që veç më ishin të mësuar ose kishin identitet personal të duhanpirjes me cigare tjera, e nuk mundej të tërheq të ri, sepse me të vërtetë nuk kushtonte shumë. Kaluan disa muaj dhe dikujt në Qeveri i kishte rënë ndërmend dhe pa shumë zhurmë e ndërpreu “Makedonija” dhe ato u zhdukën nga tregu, e në vendin e tyre erdhën filtër “Oriental”.

Filter “Oriental” e kishte integritetin e njëjtë vizual të filtër “Jugosllavija”, e njëjta kuti, ngjyra e njëjtë, grafika e njëjtë dhe cilësia ose jo-cilësia e cigares. Unë menjëherë u transferova në filtër “Oriental”, dhe sinqerisht, emri nuk më pëlqente shumë, ka një simbolikë negative, kthim nga Orienti, por kjo është temë tjetër, por as nuk më pengonte emri i ndryshuar. Të gjithë



duhanpirësit që i njihja që pinin “Jugosllavija”, e ata janë sekte e vogël, u kthyen në “Oriental”.

“Oriental” prodhohej deri vitin e kaluar, unë e konsumoja deri në kutinë e fundit dhe në shtëpi kam edhe nga një komplet “Jugosllavija” dhe “Oriental”. Prodhimi u ndërpre pasi “Filip Moris” e mori kombinatin e Prilepit, dhe në vend të brendeve të vjetra u vendosën brendet globale që sundojnë nëpër botë. Kjo nuk shkaktoi ndonjë dridhje të madhe, sepse konsumuesit e “Jugosllavija” natyrisht dhe biologjikisht u zhdukën me kalimin e viteve, ndërsa satanizimi i fisit global duhanpirës është aq i madh sa që nuk ke çfarë të thuash më në interes të ndonjë cigares.

Pavarësisht nga emri, unë i quaja filtër Jugosllavija, deri në fund, edhe kur i blija dhe i kërkoja si Jugosllavija dhe asnjëherë nuk erdhi deri në ndonjë konfuzion mes shitësit dhe mua. Çdo herë më jepte “Oriental”, ose më thoshte, “sollën filtër Jugosllavija dhe më jepte paqetë “Oriental”.

Për këtë identitet duhanpirësi ishte shumë më e rëndësishme një gjë tjetër dhe jo emri, dhe fillova të mendoj se cila është ajo gjë e cila bëri që unë t’u takoj cigareve filtër “Jugosllavija”. Me siguri, ndonjë kulturë e pirjes së duhanit dhe ajo shprehi, të ndizet pikërisht ajo cigare dhe kundërmon ashtu. E përkthyer në ndonjë identitet kombëtar ose kolektiv, me siguri kultura dhe tradita janë shumë më të rëndësishme sesa vetë emri.

Në fund të fundit, mendoj, edhe pse mund të tingëllojë si herezi, se gjuha edhe nuk është aq me rëndësi për identitetin, sa është me rëndësi kultura, traditat...

Pyetja nuk është se si do ta ruajmë gjuhën, por si do ta avancojmë kulturën tonë. Për mua është shumë problematik edhe identiteti shtetëror, gjegjësisht, shteti si komb, e



në veçanti, identiteti etnik, sepse identiteti është përcaktim personal i cili më vonë e përbën edhe identitetin kolektiv. Gjegjesisht, a ndjem unë si përkatës i ndonjë grupi ose i një gjëje dhe dua t'i ndaj vlerat e atij grupi ose gjëje...

Pse do të dëshiroja, për shembull, t'i ndaj vlerat e shtetit Maqedoni. Ato qëndirme nacional -romantike, dheu në të cilin ke lindur – është atdheu yt. Unë kam lindur në Slloveni, dhe përveç faktit që kam lindur në Slloveni, nuk kam ndonjë marrëdhënie intime me atë shtet, gjegjesisht, kam sikur ndaj të gjitha shteteve tjera. Pse do të duhej të kem qasje intime ndaj Maqedonisë? Por gjithsesi, deklaro hem si Maqedonas, tento j të jetoj jetë të mirë në këtë shtet, që nënkupton se përpigem të siguroj kushte të mira edhe për tjerët rreth meje dhe të krijoj më ndonjë vend të mirë, të përshtatshëm për jetesë... Mendoj se duhet të mëremi me lidhshmërinë funksionale mes njerëzve në bazë të interesave tjera që do të jenë materiale dhe shpirtërore dhe të cilat do të mundësojnë jetë më të mirë.

Mirëpo, identiteti im, ose identiteti i kujt do qoftë në shekullin 21 lidhet në këtë globalizëm, mendoj në interesa tjera nga ato nacionalet ose etniket. Kemi shembull të freskët për këtë, kryeministri i mëparshëm Nikolla Gruevski është në Hungari, çfarë identiteti do të ketë dhe cilat interesa e kanë shtyrë ti takojë ndonjë vendi tjetër, supozoj se nuk janë nacionale ose etnike, por ndonjë përkatësi ose identitet tjetër.

Mendoj se duhet të merremi me lidhshmëri funksionale mes njerëzve mbi baza të interesave plotësisht tjera të cilat do të jenë materiale dhe shpirtërore dhe të cilat do të mundësojnë jetë më të mirë.



Sinisha STANKOVIQ



**Dua të jetoj në
shtet me të gjitha
nishanet në të cilin
nuk do t'i
numërojmë
rruazat e gjakut**

Thjeshtë, nuk dëshiroja që askush, mes dy kafshatave djathi të mykur dhe dy fyte vere të vjetër me dekada, të diskutohet, mos dhashtë zoti, të rrihet, kush më tepër i ka ndihmuar të mbijetuarit të fundit nga Maqedonia, biblike, ose antike, kërthiza ose anusi i botës, kush si dëshiron...



Mendoja a të flas në panelin, sepse mendoj që përcaktimi im, çdo gjë që e definon identitetin tim, është e drejta ime, pjesë e intimitetit tim...Nga ana tjetër, pas parashikimeve katastrofike se me Marrëveshjen e Prespës Maqedonasit etnikë do ta humbin identitetin e tyre pavarësisht nga njohja e emrit kushtetues nga mbi 180 shtete, në atmosferë të emocioneve të nxehta, është shumë e rëndë të bëhet debat racional...Megjithatë, edhe në paraqitjet publike, edhe në tekstet e publikuara, viteve të fundit, qartë jam angazhuar për gjetje të zgjidhjes e cila do t'u ofron ardhmëri brezave të ardhshme! Ndërsa zgjidhja aktuale, edhe pse natyrisht, nuk është ideale, megjithatë ofron një farë dalje nga qorr-sokaku. Veçanërisht, që me dekada nuk është ofruar asnjë zgjidhje tjetër, serioze...

A është ideale Marrëveshja e Prespës. E qartë, nuk është. Por, a mundej të arrihet marrëveshje më e mirë dhe më e drejtë pas 27 viteve të harxhuara në të cilën politikanët e futën Maqedoninë? Për momentin, kjo nuk është e mundur, dhe mendoj se duhej të shfrytëzohet rasti për mbylljen e çështjeve të hapura – të ngarkuara me histori dhe gjak, dhe për kthim nga, të shpresojmë, ardhmëria aq sa më të mirë. A është aq e madhe sakrifica e palës maqedonase për hyrjen në një aleancë ushtarake, me premtime të mjegullta se ndonjëherë, ndoshta edhe do të bëhet anëtare e BE aq të dëshiruar? Sipas meje, megjithatë – jo, edhe pse kompromiset thjeshtë, duheshin të dhëmbin. A do të duhet të grimohet historia në marrëveshjet për bashkëpunime dhe miqësi të ardhshme, që në momentin aktual “më i fuqishmi” të mos ndjehet i ofenduar nga e kaluara e vet? Me siguri – jo, sepse pikërisht për shkak të kësaj fryme të re të miqësisë dhe fqinjësisë së mirë, faktet historike duhet të respektohen, ndërsa të gjitha palët të pihen mjaftueshëm që të munden të përballen me të kaluarën dhe të ecin përpara.



Momenti i pjekurisë në Ballkan, për fat të keq, është larg nga arritja, mirëpo, Maqedonia, nuk ishte në dispozicion të dikujt kushte. Maqedonia e shfrytëzoi rastin e ofruar dhe momentin – për shkak të matjes së forcave në planin ndërkombëtar dhe interesimin e rritur të fuqive për pozitën e saj gjeografike dhe statusin. Struktura qeverisëse thjeshtë, u thye dhe mori vendim... Dhe pranoi ta pijë një gotë verë dhe një gotë vrer.

Mirëpo, edhe kur vendosa t'i paraqes argumentet e mia, mbeti pyetja, çfarë është në fakt identiteti im?

Qenie njerëzore, gjinia mashkullore, i lindur para më tepër se pesë dekada, në një, ndërsa tani jeton në shtet tjetër, si fëmijë i prindërve- përkatës të dy popujve vëllazëror, sipas definicioneve të atëhershme, të bashkuar në komunitetin JU, por me më tepër përzjerje në gjak në historitë familjare të dy prindërve... Regjisor i parealizuar, 34 vite gazetar, kryesisht freelancer, korrespondent dhe redaktor në javore, bashkëshort, baba, dajë, gjysh -dajë, autor i disa librave, qiraxhi shumëvjeçar, nun, fqinj i mërzitshëm, njohës i mijëra njerëzve, koleg i qindrave, mik i dhjetëra, shok i... – në gishta numërohen... Dashmir i ushqimit të këndshëm dhe pikës së mirë, kohë më parë – me fjalor të bukur dhe shpresëdhënës, tani kryesisht i rezignuar dhe shumë shpesh cinik deri në palcë, d.m.th. kohë më parë i pashëm dhe i ri, tani vetëm i pashëm por edhe kjo ik me vitet...

Identiteti im është i ndërtuar në familjen në të cilën u rrita, me librat, muzikën dhe filmat, në familjen në të cilën me gjysmën më të bukur, e rritëm birin tonë, në rrugë, në shkollën fillore dhe në gjimnaz, në aksione pune, me ferialë dhe skautë, në APJ, në fakultet, në "shverc-tura" në Itali dhe Austri, në plazhet e Kretës por edhe fushat me ullinj, në dhjetëra redaksi, në udhëtime, në takime me njerëz të ndryshëm...

E gjithë kjo më ka ndërtuar, kështu si jam. E, i tillë, mendoj se



megjithatë, nuk do ta humbi(m) identitetin, sa edhe të jetë e hapur pyetja për atë “ose”... nga titulli i debatit – “Humbje e identitetit ose...?”.

Do të tregoj dy raste nga periudha e fillimeve të luftës për emrin, ngjarje për të cilat kam shkruar...

Nga mesi i viteve të nëntëdhjeta derisa në Bosnje rridhte gjaku deri në gjunjë, në kështjellën në të cilën është incizuar Sound of Music në vitin 1965, në një nga botimet e seminarit të Salzburgut me titull: “A e vrau Evropa rrugën e vet?”, morën pjesë një profesor eminent – ambasador i ardhshëm nga Serbia, dy diplomatë të rinj nga Kroacia dhe Mali i Zi, me përvojë edhe nga ambasadat Jugosllave, dhe dy gazetarë – një nga TV shërbimi nacional i Sllovenisë dhe unë, nga magazina “Puls” nga Maqedonia...)

Për shkaqe shumë të arsyeshme, nuk kishte përfaqësues zyrtar nga BeH.

Megjithatë, kishim edhe Boshnjak, mjeshtri/ekonomi i kështjellës, i cili për mrekulli luante kitarën në bodrumin e birrës, dhe të gjithë bashkështetasit e deridjeshëm, për çdo mbrëmje me këngë të “popujve dhe popullsive tonë”, tentonim ta mbulojmë çdo centimetër katror të JU – tryezës me shishe të zbrazëta të birrave..

Gjatë ditës, në temën si Evropa aq e humbi rrugën pikërisht në vendet e Bosnjës ku ndihma ishte më se e nevojshme, para tërë publikut në të cilin kishte diplomatë nga – atëherë dy Evropat dhe SHBA, me laramani titujsh dhe katesh të zeza, flisnim pikërisht ne, ish – jugosllavët... Dhe i tronditëm të pranishmit me qëndrimet e harmonizuara, të cilat shkrepnin shkëndija dhe dilnin nga fotografia bardhë e zi e krijuar nga politika dhe mediat për shtetin në të cilin kishim lindur...

Me shije të hidhur në gojë, nga mbrëmjet në të cilat u lodha me veglat për ngrënie (por më ngushëllonin me ndonjë nga dhjetëra



verat), në sesionin “boshnjak”, unë (Zinisa Stankoviç from FRJ Macedonia) e rrëfeva TV -tregimin e Top Listës së Mbi -realistëve të Sarajevës, me parashikim të zi realist, për rrahjen në tryezën festive mes përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, kush nga ata më tepër i ka ndihmuar Boshnjakut të vetëm të mbijetuar i cili ka arritur të ik nga muret e larta rreth Sarajevës...Dhe shikoja se si disa nga të pranishmit mundoheshin ta gëlltisin kafshatën time të hidhur. Dhe nuk mu bë qejfi aspak, qe, sikur, tregova diçka si është, as nuk më kënaqi duartrokitja...

Në Shkup, në 2017/2018, thjeshtë nuk dëshiroja, që askush mes dy kafshatave djathi të mykur dhe dy fyte vere të vjetër me dekada, të diskutohet, mos dhashtë zoti, të rrihet, kush më tepër i ka ndihmuar të mbijetuarit të fundit nga Maqedonia, biblike, ose antike, kërthiza ose anusi i botës, kush si dëshiron...

Gjithashtu, në mesin e viteve të nëntëdhjeta, pesëmbëdhjetë gazetarë nga Bota e Tretë dhe nga Republika Veriore e Irlandës, kryesisht nga rajone me konflikte, disa javë në mediat amerikane në dy brigjet, ishin të mësuar për zhurnalizmin dhe për demokracinë, sipas definicioneve të atëhershme amerikane (të cilat vdiqën në vitin 1999...).

Me kolegët nga Irlanda, Omani, Papua Guinea e Re, vendosëm të bëjmë pak shaka, dhe në dy ngjarje, i ndërruam tabelat në tryezat dhe bexhet me emrat në jaka. Gazetari nga Papua, me ngjyrën më të errët të lëkurës që ndonjëherë e kam pa në jetë, u prezantua si Tomi nga Irlanda, “sulltani” nga Omani – si Ziki nga Republika e Maqedonisë – no FYROM), Irlandezi, nga Tomi prej Dablini – u bë Mohamed ose diçka e ngjashme nga Omani, ndërsa unë, pas ushtrimit disa orësh të theksit për replikën time, isha Xhonatani nga Papua Guinea e Re...Dhjetëra zonja dhe zotërinj, të cilët, si lehtësim, kërkuan nga ne t’u tregojmë në globin se kush nga vjen (në globin e pa apdejtuar mezi e gjeta edhe Jugosllavinë, Maqe-



donia ende nuk ishte e vizatuar), seriozë për vdekje diskutonin me ne për “shtetet tona”. Dhe qeshnin tharbët, kur në fund i kthyem tabelat e vërteta me emrat, personale dhe të shteteve, dhe u treguam se për çfarë bëhet fjalë. Megjithatë, duke mos humbur asnjë gram nga arroganca...

Në Shkup në vitin 2017/2018 thjeshtë nuk dëshiroja, që në ndeja çaji, në mërgim, të ma vizatojnë, fshijnë dhe ndryshojnë vendin nga globi...

Dëshiroj që Maqedonia veriore të bëhet shtet i vërtetë me të gjitha tiparet, në të cilën të gjithë banorët, me të vërtetë do të jenë të barabartë para zotit të tyre dhe para ligjit, dhe do të kenë të drejta të barabarta. Asnjëherë më të mos përdoret ajo “dikush mes nesh nuk është i yni...”, dhe të gjithë ta ndajnë ndjenjën e përkatësisë, patriotizmit, identifikimit me ndonjë tërësi, si njerëz normalë dhe racionalë, të cilët mund të jetojnë në lagje të njëjtë me fqinjët, dhe t'i mos i numërojnë rruazat e gjaku.

Platforma mediale e CIVILit

www.civilmedia.mk
www.drejt.mk
www.civil.today
www.civil.org.mk
www.rtvcivil.mk
www.clp.mk
www.greencivil.mk
www.freeelections.info
www.freedom.mk

Facebook: www.facebook.com/civil.mk
Twitter: @CivilMacedonia

Kontakte:
Civil, Maksim Gorki 31/1
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë

+389 2 520 91 76
civil@civil.org.mk

shënime:

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

341.241(497.7:495):323.1(062)

HUMBJE e identitetit ose---? / [Xhabir Deralla ... [и др.]. -
Shkup : CIVIL - Qendra për Liri, 2018. - 76 стр. ; 21 см

Публикацијата е во рамките на проектот: Humbje e identitetit ose shpëtim dhe prosperitet?. - Други автори: Sasho Ordanoski, Mirjana Najçevska, Mirjana Maleska, Katerina Kollozova, Ljubço Georgievski, Diana Tahiri, Mersiha Smailloviq, Vojo Manevski, Xvezdan Georgievski, Sinisha Stankoviq

ISBN 978-608-4815-20-4

1. Deralla, Xhabir [автор] 2. Ordanoski, Sasho [автор] 3. Najçevska, Mirjana [автор] 4. Maleska, Mirjana [автор] 5. Kollozova, Katerina [автор] 6. Georgievski, Ljubço [автор] 7. Tahiri, Diana [автор] 8. Smailloviq, Mersiha [автор] 9. Manevski, Vojo [автор] 10. Georgievski, Xvezdan [автор] 11. Stankoviq, Sinisha [автор]

а) Спогодба од Преспа - Македонија - Грција - Идентитески прашања - Собири

COBISS.MK-ID 109233674

CIVIL

HEINRICH BÖLL STIFTUNG
BOSNA I HERCEGOVINA | MAKEDONIJA | ALBANIJA



ISBN-10 608-4815-20-0
ISBN-13 978-608-4815-20-4
EAN 9786084815204